



Në përputhje me nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, në zbatim të nenit 37, paragrafi 4, dhe sipas nenit 73, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 77/16 gusht 2010), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-150 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/03 prill 2017), Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 17 tetor 2024, miratoi këtë:

RREGULL
PËR PROKURIMIN
NË BANKËN QENDRORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

KAPITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME PËR AKTIVITET E PROKURIMIT

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo Rregull ka për qëllim që të sigurojë mënyrën efikase, transparente dhe të drejtë të shfrytëzimit të fondeve të Bankës Qendrore për aktivitetet e prokurimit duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që zbatohen, procedurat që ndiqen, të drejtat që respektohen dhe detyrimet që duhet të përmbushen nga subjektet që marrin pjesë ose interesohen për aktivitetet e prokurimit në Bankën Qendrore.
2. Kjo Rregull zbatohet për të gjitha aktivitetet e prokurimit të mallrave, shërbimeve dhe punëve në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Neni 2

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregull kanë këto kuptime:

1.1. **“Banka Qendrore”** nënkupton Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;

1.2. **“Prokurim”** nënkupton blerjen, marrjen me qira apo çdo mënyrë tjetër kontraktimi të mallrave, të shërbimeve ose të punëve për Bankën Qendrore;

1.3. **“Kontratë”** nënkupton kontratën e lidhur me shkrim ndërmjet Bankës Qendrore me një apo më shumë ofertues, e cila për objekt ekzekutimi ka punët, furnizimin me produkte apo ofrimin e shërbimeve;

1.4. **“Kontratë për punë”** nënkupton kontratë që për objekt ekzekutimi ka ose ekzekutimin e punëve ose dizajnin e po ashtu edhe kryerjen e punëve. ”Puna” nënkupton rezultatin e ndërtimit apo punët e teknologjisë që janë marrë si tërësi e cila është e mjaftueshme për përmbushjen e një funksioni ekonomik apo teknik;

1.5. **“Kontratë për furnizim”** nënkupton kontratën, e cila ka për objekt: blerjen, qiramarrjen, marrjen apo huazimin me apo pa opsjon për të blerë, të produkteve. Një kontratë që ka për objekt furnizimin me produkte që po ashtu sipas rastit, mbulon operacionet mirëmbajtëse dhe të instalimit konsiderohet si ”kontratë për furnizim”;

1.6. **“Kontratë për shërbime”** nënkupton kontratën, përveç kontratave për punë dhe furnizim që për objekt kanë ofrimin e shërbimeve. Një kontratë që për objekt të saj ka si produktet ashtu edhe shërbimet konsiderohet si ”kontratë për shërbime” nëse vlera e llogaritur e shërbimeve në fjalë tejkalon atë të produkteve të mbuluara nga kontrata. Një kontratë që për objekt të saj ka shërbimet që përfshijnë aktivitetet që kanë të bëjnë me punët

të cilat janë të rastësishme për objektin kryesor të kontratës konsiderohet të jetë kontratë për shërbime;

1.7. **“Kontratë kornizë”** nënkupton një marrëveshje me shkrim ndërmjet Bankës Qendrore dhe një apo më tepër operatorëve ekonomikë, qëllimi i së cilës është përcaktimi i kushteve, që rregullojnë kontratat të cilat do të jepen gjatë një periudhe të caktuar, në veçanti në lidhje me çmimin dhe sipas nevojës sasinë e paraparë;

1.8. **“Zyrtar Autorizues”** nënkupton Guvernatorin e Bankës Qendrore me përgjegjësi për inicimin e një aktiviteti të prokurimit;

1.9. **”Ofertues”** nënkupton çdo person fizik apo juridik apo entitet publik ose grup i personave dhe/apo organeve të cilët ofertojnë në treg, respektivisht, ofrojnë ekzekutimin e punëve, produkte apo shërbime. Ofertuesi që ka parashtruar një kërkesë për të marrë pjesë në një procedurë të kufizuar apo të negociuar apo në një dialog konkurrues konsiderohet si ”kandidat”. Kandidati që ka paraqitur një tender konsiderohet si ”tenderues”;

1.10. **“Procedura e hapur”** nënkupton një procedurë prokurimi në të cilën çdo ofertues i interesuar mund të paraqesë një tender;

1.11. **“Procedura e kufizuar”** nënkupton një procedurë prokurimi në të cilën çdo ofertues mund të bëjë kërkesë për pjesëmarrje dhe vetëm kandidatët e ftuar nga Banka Qendrore mund të paraqesin tenderin;

1.12. **“Procedura konkurruese me negocim”** nënkupton një procedurë prokurimi në të cilën Banka Qendrore merr në konsideratë ofertuesit sipas zgjedhjes së saj dhe negocion rreth kushteve të kontratave me një apo më shumë prej tyre;

1.13. **“Procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë”** nënkupton një procedurë prokurimi, në të cilën Banka Qendrore nuk ka qëllim mosrespektimin e procedurave të tjera, por hyn në marrëdhënie dhe kërkon një propozim (ofertë) vetëm nga një ofertues. Kjo procedurë zbatohet për raste specifike siç përshkruhen në këtë rregull, veçanërisht për prokurimet që lidhen ekskluzivisht me zbatimin efikas të mandatit dhe objektivave të BQK-së.

1.14. **“Negocim konkurrues”** nënkupton procedurat sipas kësaj Rregulle në të cilat çdo kandidat mund të bëjë kërkesë për pjesëmarrje, me anë të të cilit Banka Qendrore zhvillon një dialog negociues me kandidatët e pranuar në atë procedurë, me qëllim të zhvillimit të një apo më tepër alternativave të përshtatshme që janë në gjendje t’i plotësojnë kërkesat e saj;

1.15. **“Sistemi prokurues dinamik”** nënkupton një procedurë prokurimi me një proces krejtësisht elektronik për kryerjen e blerjeve të zakonshme, karakteristikat e të cilit, siç janë përgjithësisht në dispozicion në treg, i plotësojnë kërkesat e Bankës Qendrore. Sistemi është i kufizuar në kohëzgjatje dhe është i hapur gjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së tij për çdo ofertues, që i plotëson kriteret e përzgjedhjes dhe që ka paraqitur një tender në përputhje me specifikimin;

1.16. **“Ftesa për tender”** nënkupton ftesën që u dërgohet ofertuesve për paraqitjen e tenderit dhe që specifikon procedurën, kërkesat e Bankës Qendrore, kriteret kontraktuese dhe kushtet;

1.17. **“Tender ndërkombëtar”** nënkupton tenderin i cili zhvillohet sipas procedurave të përcaktuara sipas kësaj Rregulle dhe përdoret kur mallrat, shërbimet apo punët që do të prokurohen nuk janë të siguruara nga burimet vendase dhe nuk ka konkurrencë të mjaftueshme brenda vendit;

1.18. **“Komisioni vlerësues i prokurimit”** nënkupton komisionin e caktuar për hapjen, shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të procesit të prokurimit sipas kësaj Rregulle;

1.19. **“E shkruar”** apo **“me shkrim”** nënkupton çdo shprehje që përbëhet nga fjalët apo shifrat të cilat mund të lexohen, riprodhohen dhe më pas të komunikohen. Mund të përfshijë informatat të cilat transmetohen apo ruhen nga mjetet elektronike;

1.20. **“Ditët”** nënkupton ditët kalendarike.

1.21. **“Gjuhë komunikimi”** nënkupton gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës (shqip/serbisht) dhe në procedurat për tender ndërkombëtar gjuha angleze.

1.22. **“Kontraktimi”** si funksion i veçantë në kuadër të Divizionit të Prokurimit dhe Kontraktimit (DPK) nënkupton hartimin e kontratave të prokurimit, interpretimin, si dhe monitorimin e tyre deri në përfundim të afatit kohor të kontratës përkatëse.

1.23. **“Menaxhimi i kontratave”** nënkupton aktivitetet e zbatueshme për të siguruar që dispozitat e një kontrate të prokurimit lidhur me dorëzimin me kohë e në mënyrë korrekte, dhe të drejtat e tjera e detyrimet e palëve nënshkruese të ushtrohen në mënyrë efektive.

1.24. **“Standard Evropian”** - standardet e miratuara nga (i) Komiteti Evropian për Standardizime (European Committee for Standardization, CEN) ose nga Komiteti Evropian për Standardizimin Elektroteknik (European Committee for Electrotechnical Standardization CENELEC) si “Standard Evropian” (European Standard, EN) ose “Dokumentet Harmonizimi” (Harmonization Document, HD), në përputhje me rregullat e përbashkëta të këtyre organizatave, ose (ii) nga Instituti Evropian i Standardeve të Telekomunikacionit (European Telecommunication Standards Institute, ETSI) në pajtim me rregullat e tyre si Standarde Evropiane të Telekomunikacionit (European Telecommunications Standard, ETS).

1.25. **“Operator ekonomik”** – term i përgjithshëm që përfshin furnizuesit, ofruesit e shërbimeve dhe/ose kontraktuesit e punëve.

1.26. **“Palë e interesuar”** – operatori ekonomik që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i një aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga Banka Qendrore në raport me një kontratë të prokurimit.

1.27. **Formulari standard i planit të menaxhimit të kontratës** – nënkupton formularin i cili hartohet dhe mirëmbahet nga Divizioni i Prokurimit dhe Kontraktimit.

1.28. **“Sistemi i prokurimit elektronik”** – nënkupton sistemin elektronik të cilin BQK e zhvillon dhe e zbaton për realizimin e procedurave të prokurimit, sipas llojit, procedurës dhe vlerës përkatëse.

1.29. **“Grup i operatorëve ekonomikë (konzorcium)”** – nënkupton grupet e përkohshme të partneritetit, ndryshe të njohura si konzorciume, që mund marrin pjesë në një procedurë për tender sipas kushteve të caktuara. Banka Qendrore mund të kërkojë nga grupet e tilla që të miratojnë një formë specifike ligjore nëse kontrata iu jepet atyre, nëse kjo formë është e nevojshme për përmbushjen e duhur të kontratës.

1.30. **“Konflikt interesi”** – në proceset e prokurimit sipas kësaj Rregulle, nënkupton çdo situatë ku personeli i Bankës Qendrore i përfshirë në një procedurë të prokurimit ka drejtpërdrejt apo tërthorazi interes personal financiar, ekonomik apo ndonjë interes tjetër që mund të perceptohet për kompromis të paanshmërisë dhe pavarësisë së tyre në kontekstin e procedurës së prokurimit.

1.31. **“Eliminim nga procedura”** – nënkupton eliminimin ose përjashtimin e një tenderi/oferte nga një procedurë e prokurimit që zhvillohet sipas kësaj Rregulle, sipas rasteve të përkufizuara në nenet dhe paragrafët përkatës. Çdo tender apo kandidat i cili cilësohet i pa-përgjegjshëm eliminohet nga procedura e prokurimit. Në raste të caktuara në këtë Rregull eliminimin e hasim edhe si refuzim, e që ka të njëjtin kuptim kur bëhet fjalë për eliminimin e një oferte ose kërkesë për pjesëmarrje.

1.32. **“Tenderët e pa-përgjegjshëm”** – nënkupton tenderin i cili nuk është në përputhje me dosjen e tenderit, duke përfshirë kërkesat teknike dhe ato kontraktuale, kërkesat e kësaj Rregulle, përndryshe nuk përmbush kërkesat e Bankës Qendrore siç janë specifikuar në dosjen e tenderit.

1.33. **“Komisioni i ankesave”** – nënkupton komisionin e mandatuar njëvjeçar të emëruar nga Guvernatori bazuar në natyrën profesionale dhe specifikat e procedurave të prokurimit.

1.34. **“Kandidat/tenderues i përgjegjshëm”** - në çdo procedurë prokurimi, nënkupton kandidatin ose tenderuesin pjesëmarrës i cili i plotëson të gjitha kriteret dhe kushtet e caktuara nga ana e Bankës Qendrore.

1.35. **“Deklarata e specifikimeve teknike”** – nënkupton formularin standard i cili përgatitet dhe mirëmbahet nga Divizioni i Prokurimit dhe Kontraktimit dhe i cili plotësohet në çdo rast nga njësitë kërkuese ku paraqesin specifikat teknike për furnizime, punë ose shërbime.

1.36. **“Komiteti i projekteve”** – nënkupton komitetin e emëruar nga Guvernatori që do të ketë mandat dhe mision të caktuar për vlerësimin e arsyeshmërisë dhe të realizueshmërisë

së projekteve kapitale që realizohen përmes procedurave të prokurimit, si dhe do të monitorojë implementimin e tyre. Ky komitet nuk ka mandat të përfshihet në procesin e prokurimit, por ka rol para dhe pas zbatim të tij.

Neni 3 **Përfshirjet**

1. Kjo Rregull nuk zbatohet për kontratat e paraqitura në vijim:

1.1. Prokurimin e kartëmonedhave dhe të monedhave;

1.2. Lëshimin, shitjen, blerjen apo transferimin e letrave me vlerë apo instrumenteve financiare, duke përfshirë arin dhe shërbimet financiare që ndërlidhen me këto transaksione;

1.3. Operimin me llogaritë dhe transaksionet e jashtme; dhe

1.4. Kontratat e punësimit ndërmjet Bankës Qendrore dhe personelit të saj të lidhura në pajtim me Politikën për Marrëdhënien e Punës në Bankën Qendrore.

2. Përfshirje nga kjo Rregull përbëjnë gjithashtu kontratat, pavarësisht vlerës së tyre, të cilat Banka Qendrore mund t'i japë në rastet kur objekt i tyre janë furnizimet ose shërbimet si vijon:

2.1. Shërbimet ligjore dhe shërbimet specifike konsulente;

2.2. Shërbime dhe furnizimet rreth organizimit dhe mbajtjes së konferencave nga ana e BQK-së;

2.3. Shërbimet e çështjeve të sigurisë dhe të hetimit;

2.4. Shërbimet e shkollimit dhe të edukimit profesional të stafit;

2.5. Shërbimet dhe furnizimet për aktivitete rekreative, kulturore dhe të sportit;

2.6. Marrjen me qira dhe blerjen e pronave të paluajtshme;

2.7. Furnizimet e shërbimet e ofruara nga ndërmarrjet publike si (shërbimet postare, ato të furnizimit me ujë, ngrohje, energji elektrike, etj.);

2.8. Shërbimet dhe furnizimet hoteliere dhe ato të restorantit.

Neni 4 **Parimet e përgjithshme**

1. Çdo procedurë prokurimi zbatohet në përputhje me parimet e përgjithshme të transparencës dhe të publikimit, të qasjes së barabartë dhe të trajtimit të barabartë, si dhe me parimet e mosdiskriminimit dhe të konkurrencës së drejtë.

2. Gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit, do të respektohet gjithashtu parimi i ekonomicitetit dhe efikasitetit sipas kriterit “vlera për paranë”, duke u siguruar se fondet e BQK-së do të përdoren ekonomikisht, sipas qëllimit dhe lëndës së prokurimit.

Neni 5

Llogaritja e afateve

1. Afatet kohore të kësaj Rregulle duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor përfundon në ora 16:00 në ditën e skadimit.

2. Vikendet dhe festat zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diel ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj.

Neni 6

Mundësia e prokurimit elektronik

1. Banka Qendrore mund të zbatojë një sistem të prokurimit elektronik të aplikueshëm për të gjitha llojet dhe procedurat e prokurimit sipas dispozitave të kësaj Rregulle, dhe për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar dhe pjesëmarrës në procedurat e prokurimit që zhvillohen nga Banka Qendrore.

2. Në zbatim të paragrafit 1 të këtij neni, Banka Qendrore zhvillon një sistem elektronik të prokurimit të sigurt dhe të qëndrueshëm në pajtim me standardet dhe praktikat më të mira vendore dhe ndërkombëtare të aplikueshme në këtë fushe, në lidhje me pajisjet e dorëzimit elektronik dhe të pranimin të tenderëve si dhe për pajisjet për pranimin elektronik të kërkesave për pjesëmarrje. Këtu mund të përfshihet edhe aspekti i nënshkrimit të avancuar elektronik që do të aplikohet, në pajtim me standardet ndërkombëtare.

3. Pas përmbushjes së të gjitha kushteve procedurale e teknike për përdorim të prokurimit elektronik, Guvernatori apo personi i autorizuar prej tij/saj do të marrë vendim për fillimin e zbatimit të kësaj forme të prokurimit, sipas vlerësimit dhe nevojave të BQK-së.

4. Për zbatimin e këtij neni, Banka Qendrore do të nxjerrë procedurë përkatëse.

KAPITULLI II

PROCEDURAT E PROKURIMIT

Neni 7

Planifikimi i prokurimit

1. Planifikimi i prokurimit për aktivitetet e prokurimit në Bankën Qendrore bëhet për një periudhë kohore prej dymbëdhjetë (12) muajve. Planifikimi i prokurimit identifikon furnizimet, shërbimet dhe punët që Banka Qendrore parasheh t'i prokurojë gjatë vitit të ardhshëm fiskal.
2. Divizioni i Prokurimit dhe Kontraktimit brenda tremujorit të fundit të vitit vijues përgatit planin preliminar të prokurimit për vitin e ardhshme. Plani preliminar përgatitet sipas komunikimeve të realizuara me njësitë kërkuese brenda BQK-së dhe informatave që dërgohen nga njësitë kërkuese të cilat më pastaj trajtohen nga Komiteti i Projekteve, siç përshkruhet në nenin 8.
3. Pas aprovimit të buxhetit vjetor të BQK-së, në një afat prej më së shumti 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas konfirmimit të informatave nga njësitë kërkuese për buxhetin e aprovuar, finalizohet plani përfundimtar i prokurimit.
4. Plani vjetor i prokurimeve, përveç identifikimit sipas paragrafit 1 të këtij neni, përmban edhe vlerën e parashikuar të secilës kontratë për furnizime, punë e shërbime që planifikohet të realizohen përmes procedurave të prokurimit.
5. Plani përfundimtar i prokurimit miratohet nga Bordi Ekzekutiv dhe një version i reduktuar mund të publikohet në ueb-faqen zyrtare të BQK-së. Plani përfundimtar i prokurimit mund të ndryshohet nga Bordi Ekzekutiv sipas arsyeshmërisë dhe me rekomandim të Komitetit të Projekteve, ose rasteve kur ndonjë aktivitet i prokurimit ndryshohet ose shtohet me rishikim të buxhetit të Bankës Qendrore.
6. Divizioni i Prokurimit dhe Kontraktimit përgatit dhe mirëmban formularin standard të planifikimit të prokurimit me informatat e nevojshme, në kuadër të dokumenteve tjera standarde të prokurimit.

Neni 8

Komiteti i projekteve

1. Komiteti i projekteve është grup pune i cili në kuadër të kësaj Rregulle do të ketë tri funksione kryesore:
 - 1.1. Vlerësimin e arsyeshmërisë dhe të realizueshmërisë së projekteve kapitale të cilat planifikohen të realizohen përmes procedurave të prokurimit në BQK;

- 1.2. Monitorimin periodik të ecurisë së implementimit të këtyre projekteve; dhe
- 1.3. Rekomandimin e veprimeve të nevojshme nga pika 1.2. në rastin kur hasen vështirësi në nisjen ose zbatimin e projektit.

2. Në fazën e parë të vlerësimit të arsyeshmërisë dhe të realizueshmërisë së projekteve kapitale, Komiteti do të jetë i ngarkuar me detyrë për ta bërë një vlerësim preliminar për nevojën, rëndësinë dhe ndërlidhjen e projektit me objektivat, detyrat dhe planin strategjik të BQK-së nga informatat që vijnë prej njësive organizative të BQK-së, njëkohësisht njësitë e kërkesave sipas kësaj Rregulle. Lista e projekteve të vlerësuara nga Komiteti do të rekomandohet tek Guvernatori dhe e njëjta do të shqyrtohet dhe miratohet nga Bordi Ekzekutiv. Të njëjtat reflektohen në buxhetin e vitit përkatës.

3. Në fazën e dytë të monitorimit të implementimit të projekteve, Komiteti informohet nga menaxherët e kontratave dhe nga Divizioni i Prokurimit dhe Kontraktimit në baza periodike për ecurinë, sfidat dhe nivelin e zbatimit të projekteve dhe raporton përmes Zëvendësguvernatorit të shtyllës përgjegjëse te Guvernatori.

4. Komiteti i projekteve emërohet nga Guvernatori. Do të ketë përbërje prej 3 (tre) deri në 5 (pesë) anëtarë, dhe kryesohet nga Zyra e Guvernatorit. Komiteti do të bashkëpunojë ngushtë me të gjitha njësitë e kërkesës brenda BQK-së të cilat planifikojnë realizimin e projekteve dhe po ashtu edhe me Divizionin e Prokurimit dhe Kontraktimit.

5. Mandati i Komitetit do të vendoset me vendim nga Guvernatori, ku përcaktohen qartë detyrat e këtij grupi.

Neni 9

Procedurat e prokurimit në Bankën Qendrore

1. Gjatë kryerjes së aktiviteteve të prokurimit, Banka Qendrore shfrytëzon njëërën nga procedurat e përcaktuara sipas kësaj Rregulle.
2. Banka Qendrore në parim zbaton procedurën e hapur të prokurimit, për aq sa kjo mund të jetë e mundur dhe nuk pengon zbatimin e mandatit dhe detyrave të saj.

Neni 10

Procedura e hapur

1. Procedura e hapur fillon me publikimin e njoftimit për kontratë. Publikimi bëhet në uefaqen e Bankës Qendrore si dhe në mediat tjera elektronike zyrtare të BQK-së. Pas publikimit të njoftimit për kontratë, të gjithë të interesuarit mund të kërkojnë dosjen e tenderit dhe të bëjnë dorëzimin e ofertës. Banka Qendrore shpërndan dosjen e tenderit brenda afatit prej tre (3)

ditëve nga dita e pranimit të kërkesës, me kusht që kërkesa të jetë bërë me kohë para skadimit të afatit për paraqitjen e tenderëve.

2. Në njoftimin e kontratës specifikohet limiti kohor për parashtrim të kërkesës për dosje të tenderit nga të interesuarit. Kandidatët paraqesin tenderët e tyre brenda afateve të caktuara nga Banka Qendrore dhe përfshijnë gjithë dokumentacionin e kërkuar nga Banka Qendrore.

3. Banka Qendrore lidh kontratë me tenderuesin i cili i plotëson kriteret për dhënien e tenderit, bazuar në shpalljen publike sipas kriterëve të përcaktuar në njoftimin për kontratë/ftesën për tender.

4. Njoftimi për shpallje të fituesit nuk përben obligim për BQK-në, dhe as të drejtë për fituesin, deri në lidhjen e kontratës. BQK rezervon të drejtën që të mos nënshkruajë kontratën nëse sipas vlerësimit të saj profesional, e njëjta do të vështirësojë arritjen e objektivave të saj.

Neni 11

Procedura e kufizuar

1. Banka Qendrore mund të shfrytëzojë procedurat e kufizuara për të kryer një aktivitet prokurimi deri te dhënia e ndonjë kontrate në bazë të faktorëve të verifikueshëm sipas paragrafit 3 të këtij neni.

2. Pas pranimit të kërkesave për pjesëmarrje dhe aplikacioneve në fazën para-kualifikuese, Banka Qendrore fton me shkrim që të parashtrojnë tenderin kandidatët të cilët përmbushin kriteret e caktuara të përzgjedhjes në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit në përputhshmëri me këtë Rregull. Kandidatët të cilët nuk i plotësojnë kriteret sipas këtij neni eliminohen nga pjesëmarrja e mëtutjeshme.

3. Banka Qendrore zbaton procedurën e kufizuar sipas faktorëve të verifikueshëm si në vijim:

3.1. Kriteret specifike të përzgjedhjes të përcaktuara nga Banka Qendrore që mundësojnë krahasueshmëri të operatorëve ekonomikë në mënyrë objektive; dhe

3.2. Kufizimi i numrit i tenderëve për shkak të natyrës së prokurimit.

4. Pas publikimit të njoftimit për kontratë, të interesuarit mund të bëjnë kërkesë për pjesëmarrje në procedurë të kufizuar brenda afatit të specifikuar në njoftimin për kontratë dhe të ofrojnë dokumentacionin e kërkuar nga Banka Qendrore.

5. Banka Qendrore në fazën e parë verifikon përshtatshmërinë e kandidatëve dhe vlerëson, nëse kërkesat i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes të caktuara në njoftimin për kontratë. Banka Qendrore fton për tender në fazën e dytë së paku 2 (dy) dhe më së shumti 5 (pesë) kandidatë të pranueshëm, të cilët i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes sipas këtij neni për paraqitjen e tenderit. Në raste kur më shumë se 5 tenderues i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes, atëherë aplikohen kriteret specifike për përzgjedhje. Ftesa për tender iu dërgohet me shkrim njëkohësisht të gjithë kandidatëve të ftuar për paraqitjen e tenderit.

6. Tenderuesit/ofertuesit e ftuar i paraqesin tenderët e tyre brenda afatit të caktuar nga Banka Qendrore dhe përfshijnë gjithë dokumentacionin e kërkuar nga Banka Qendrore.
7. Banka Qendrore lidh kontratë me tenderuesin i cili i plotëson më së miri kriteret për dhënien e kontratës të caktuar në ftesën për tender.
8. Njoftimi për shpallje të fituesit nuk përbën obligim për BQK-në, dhe as të drejtë për fituesin, deri në lidhjen e kontratës. BQK rezervon të drejtën që të mos nënshkruajë kontratën nëse sipas vlerësimit të saj profesional, e njëjta do të vështirësojë arritjen e objektivave të saj.

Neni 12

Procedura konkurruese me negociim

1. Banka Qendrore zbaton procedurën konkurruese të negociuar vetëm në këto raste të veçanta:
 - 1.1. Nëse natyra e punëve, furnizimeve apo shërbimeve ose rreziqet e ndërlidhura me to nuk lejojnë caktimin paraprak të çmimeve të përgjithshme;
 - 1.2. Nëse natyra e shërbimeve apo e punëve është e atillë që specifikimet nuk mund të vërtetohen me precizitet të mjaftueshëm, për të lejuar dhënien e kontratës nëpërmjet përzgjedhjes së tenderuesit më të mirë sipas rregullave, që përcaktojnë procedurat e hapura apo të kufizuara.
2. Banka Qendrore gjithashtu mund të shfrytëzojë procedurën e negociuar kur nuk merren tenderë të pranueshëm në përgjigje të një procedure të hapur apo të kufizuar (konkurrues), për aq sa kushtet origjinale të kontratës nuk ndryshohen në mënyrë substanciale. Banka Qendrore mund të mos publikojë njoftim të ri për kontratë nëse në procedurën e negociuar përfshin ekskluzivisht të gjithë tenderuesit që kanë aplikuar në procedurën e mëhershme, të cilët i kanë plotësuar kriteret e përzgjedhjes dhe që i kanë paraqitur tenderët e tyre në përputhje me kërkesat formale për tender. Nëse nuk janë siguruar tenderë apo nuk paraqiten tenderë që i plotësojnë kërkesat formale të tenderit, Banka Qendrore gjithashtu mund të fillojë procedurën e negociuar pa njoftim në përputhje me nenin 45 të kësaj Rregulle.
3. Pas publikimit të njoftimit për kontratë, ofertuesit e interesuar mund të bëjnë kërkesë për pjesëmarrje në procedurë të negociuar. Kërkesa e tillë do të paraqitet brenda afatit të caktuar në njoftimin për kontratë.
4. Banka Qendrore verifikon përshtatshmërinë e tenderuesve dhe vlerëson nëse kërkesat i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes të caktuara në njoftimin për kontratë. Banka Qendrore fton së paku tre (3) kandidatë të pranueshëm të cilët i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes për paraqitjen e tenderit, me kusht që një numër i mjaftueshëm i kandidatëve që i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes janë në dispozicion. Ftesa për tender u dërgohet me shkrim dhe njëkohësisht të gjithë kandidatëve të ftuar për paraqitjen e tenderit.
5. Pas vlerësimit të tenderëve, Banka Qendrore negocion me tenderuesit me qëllim të harmonizimit të tenderit të tyre me kërkesat e saj.

6. Banka Qendrore mund të fillojë negociatat:

6.1. Me tenderuesit e rangut më të lartë. Nëse negociatat me tenderuesit e rangut më të lartë dështojnë, Banka Qendrore mund të bëjë negociata me tenderuesit e rangut të ardhshëm; ose

6.2. Njëkohësisht me të gjithë tenderuesit që kanë paraqitur një tender e të cilët në mënyrë esenciale i plotësojnë kërkesat teknike dhe funksionale të Bankës Qendrore. Në këtë rast, numri i tenderuesve të pranuar për negociata mund të zvogëlohet në faza të vazhdueshme, duke zbatuar kriteret e dhënies së kontratës të caktuara në njoftimin e kontratës apo ftesën për tender.

7. Para fillimit të negociatave, Banka Qendrore i informon të gjithë tenderuesit se si zhvillohen negociatat. Gjatë negociatave, Banka Qendrore siguron trajtim të barabartë për të gjithë tenderuesit e ftuar për negociata.

8. Banka Qendrore mund t'i ftojë tenderuesit ta paraqesin tenderin e tyre të rishikuar.

9. Banka Qendrore e kontraktin tenderuesit që më së miri i plotëson kriteret e caktuara në njoftimin për kontratë apo në ftesën për tender.

Neni 13

Procedura për kuotim çmimesh

1. Banka Qendrore zbaton procedurën për kuotim çmimesh atëherë kur vlera e llogaritur nuk tejkalon pragun e caktuar në nenin 19, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1, të kësaj Rregulle për furnizime dhe shërbime dhe nenin 19, paragrafi 3, nënparagrafi 3.2, të kësaj Rregulle për kontrata pune.

2. Numri i ofertuesve që do të ftohen të kuotojnë duhet të jetë i mjaftueshëm për të siguruar konkurrencë efektive në kontratë dhe nuk duhet të jetë më pak se dy (2).

3. Ftesat për kuotim do t'u shpërndahen njëkohësisht ofertuesve potencialë. Dosja e tenderit do t'i bashkëngjitet ftesës. Afati minimal kohor për dorëzimin e kuotimeve për çmime është pesë (5) ditë kalendarike nga dita e shpërndarjes së ftesave.

4. Ofertuesit që nuk janë ftuar për të kuotuar, mund të kërkojnë një ftesë nga Banka Qendrore, e cila duhet t'iu dërgojë ftesën operatorëve në fjalë. Këto kërkesa nuk do të ndikojnë në datën e caktuar për dorëzim të kuotimeve.

5. Ofertuesit që nuk janë ftuar nga Banka Qendrore të bëjnë kuotim, por që e kanë marrë një kopje të ftesës ose informacion për procedurën nga një palë tjetër, kanë të drejtë të dorëzojnë kuotim të çmimeve. Kuotimi i çmimeve të dorëzuar nga operatori i tillë ekonomik trajtohet njëjtë sikur ofertuesit tjerë.

Neni 14

Procedura për blerje me vlerë minimale

1. Banka Qendrore mund të zbatojë procedurën për blerje me vlerë minimale për blerjen e mallrave, shërbimeve dhe/apo punëve. Zyrtari i prokurimit kontakton së paku tre (3) operatorë ekonomikë të mallrave, të shërbimeve apo të punëve në fjalë. Banka Qendrore është e obliguar që të dokumentojë kontaktimin e operatorëve, duke prodhuar regjistrin e operatorëve ekonomikë të kontaktuar. Banka Qendrore pasi që ka kontaktuar së paku tre (3) ofertues edhe nëse nuk i pranon tri oferta vazhdon me një ofertë të përgjegjshme.
2. Banka Qendrore do të përzgjedhë ofertuesin që ka ofruar çmimin më të ulët, i cili do të realizojë aktivitetin e prokurimit.
3. Për qëllim të këtij neni vlerë minimale konsiderohet vlera, shuma e së cilës nuk tejkalon pragun 5,000 (pesë mijë) euro. Në këto raste komisioni vlerësues aplikohet në pajtim me nenin 36 të kësaj Rregulle.
4. Përrjashtimisht nga paragrafi 3 i këtij neni, për blerjet e vogla apo minimale, vlera e të cilave parashikohet të jetë e barabarte ose më e vogël se 1,000 (një mijë) euro, Banka Qendrore mundet që të mos zbatojë procedurë prokurimi. Në çdo rast, blerjet e tilla do të bëhen në formë direkte duke pasur gjithmonë parasysh kriterin e vlerës së parasë dhe sigurimin e cilësisë së furnizimit, shërbimit apo punës në të mirë të Bankës Qendrore. Në këtë rast, për vlerat mbi 100 (njëqind) euro, dokumentohet kërkimi i tregut për çmimet referente, përveç rasteve kur produkti është ekskluziv dhe s'ka reference tjetër në treg.
5. Përrjashtimisht nga paragrafi 3 i këtij neni, për prokurimet që realizohen me procedurë me vlerë minimale, për shumat prej 1,000 (një mijë) deri në 3,000 (tre mijë) euro, Banka Qendrore formon komision vlerësues me dy anëtarë dhe nënshkruan kontratë standarde të prokurimit, e cila mund të jetë edhe në formë të Formularit të procedurës me vlerë minimale, si mjet i konfirmuar juridikisht për këtë qëllim; i njëjti nënshkruhet nga të dyja palët në rastet e tilla.

Neni 15

Procedura e negociuar pa publikim

1. Procedura e negociuar pa publikim mund të zbatohet sipas arsyeshmërisë së dhënë nga njësia kërkuese në rastin e një kontrate të re apo nga menaxheri i kontratës në rastin e një kontrate ekzistuese (paraprake). Në dokumentin e arsyeshmërisë së dhënë, njësia kërkuese ofron informatat e nevojshme se me cilin rast sipas dispozitave më poshtë të këtij neni lidhet kërkesa përkatëse e prokurimit, dhe në rastet e kontratave të reja, në dokumentin e arsyeshmërisë njësia kërkuese ofron informata rreth operatorit ekonomik me të cilin realizohen negociatat sipas kësaj procedure. Me rekomandim të zëvendësguvernatorit të shtyllës përkatëse, autorizimi për zbatimin e kësaj procedure në çdo rast jepet nga Guvernatori:

1.1. Për prokurimet me vlerë të vogla dhe të mesme vlen kërkesa/arsyeshmëria e dhënë nga njësia kërkuese përmes zëvendësguvernatorit të shtyllës përkatëse dhe aprovimi nga Guvernatori për zbatimin e kësaj procedure.

1.2. Për prokurimet me vlera të mëdha vlen kërkesa/arsyeshmëria e dhënë nga njësia kërkuese me aprovim paraprak nga zëvendësguvernatori i shtyllës përkatëse dhe aprovim përfundimtar nga Guvernatori për zbatimin e kësaj procedure.

2. Divizioni i prokurimit dhe kontraktimit përgatit formularin standard të autorizimit të kësaj procedure sipas dispozitave më lart të këtij neni.

3. Procedura e negociuar pa publikim mund të zbatohet në rastet si më poshtë:

3.1. Për prokurimet që për lëndë kanë furnizimet, punët apo shërbimet të cilat lidhen ekskluzivisht me zbatimin e mandatit dhe objektivave të BQK-së. Një vlerësim i tillë për zbatimin e kësaj procedure për prokurimet që lidhen me mandatin e BQK-së kalon në dy nivele, fillimisht në nivelin e arsyeshmërisë së dhënë nga njësia e kërkesës dhe në nivelin e vlerësimit nga Komiteti i projekteve. Njësia e kërkesës në pajtim me vlerësimin e Komitetit të Projekteve, përmes zëvendësguvernatorit të shtyllës përkatëse (për secilën fushë), rekomandon aprovimin të Guvernatori.

3.2. Në rastet kur në mungesë të konkurrencës për arsye teknike mallrat, shërbimet apo punët sigurohen vetëm nga një operator ose kur një kontraktues ka të drejtën ekskluzive për mallrat, shërbimet apo punët;

3.3. Për furnizime apo shërbime të ofruara nga kontraktuesi i mëparshëm, të cilat bëhen ose si zëvendësim ose si shtim i mallrave dhe/ose shërbimeve ekzistuese dhe kur një ndryshim i kontraktuesit detyron Bankën Qendrore të prokurojë mallra dhe/ose shërbime, të cilat nuk plotësojnë kërkesat e përshtatshmërisë me mallrat ose me shërbimet ekzistuese. Kjo për vlerë jo më të madhe se njëzet (20%) për qind e çmimit të kontratës fillestare dhe kur nevoja për këtë shtesë del gjatë kohës së realizimit të kontratës, deri në tre (3) muaj pas përfundimit të saj; Një proces i tillë shoqërohet me një memo sqaruese nga njësia kërkuese përmes zëvendësguvernatorit të shtyllës përkatëse.

3.4. Në rastet kur shërbimet suplementare të ndërtimit, të cilat nuk janë në kontratën fillestare, për shkak të rrethanave të paparashikueshme, janë bërë të domosdoshme dhe ndarja e shërbimeve suplementare të ndërtimit nga kontrata fillestare është e vështirë për arsye teknike ose ekonomike. Kjo për vlerë jo më të madhe se njëzet (20%) për qind e çmimit të kontratës fillestare dhe kur nevoja për këtë shtesë del gjatë kohës së realizimit të kontratës, deri në tre (3) muaj pas përfundimit të saj; Një proces i tillë shoqërohet me një memo sqaruese nga njësia kërkuese përmes zëvendësguvernatorit të shtyllës përkatëse.

3.5. Për shërbime të reja ndërtimi, që konsistojnë në përsëritjen e shërbimeve të ngjashme të ndërtimit, të cilat janë sipas projektit bazë, me kusht që për këtë projekt kontrata fillestare të jetë lidhur mbi bazën e procedurës së hapur ose të kufizuar. Kjo për vlerë jo më të madhe se njëzet (20%) për qind e çmimit të kontratës fillestare dhe kur nevoja për këtë shtesë del

gjatë kohës së realizimit të kontratës, deri në tre (3) muaj pas përfundimit të saj; Një proces i tillë shoqërohet me një memo sqaruese nga njëسيا kërkuese përmes zëvendësguvernatorit të shtyllës përkatëse.

3.6. Për vazhdimin e shërbimeve të konsulencës për të cilat kontrata fillestare është zbatuar në mënyrë të kënaqshme dhe vazhdimi i këtyre shërbimeve mund të sjellë avantazhe ekonomike dhe efektivitet; Një proces i tillë shoqërohet me një memo sqaruese nga njëسيا kërkuese përmes zëvendësguvernatorit të shtyllës përkatëse.

3.7. Për blerje ose shërbime, të cilat janë të lidhura me cilësi personale të kandidatit-individit (si për shembull, piktura, skulptura, programime, konsulencë, përkthime, etj.); Një proces i tillë shoqërohet me një memo sqaruese nga njëسيا kërkuese përmes zëvendësguvernatorit të shtyllës përkatëse.

3.8. Për vazhdimin e shërbimeve të projektimit që janë të lidhura me shërbime tjera të kryera më parë, të cilat po t'i jepeshin një subjekti të ri cenojnë të drejtën e autorit; Një proces i tillë shoqërohet me një memo sqaruese nga njëسيا kërkuese përmes zëvendësguvernatorit të shtyllës përkatëse.

3.9. Për rastet e blerjes së mallrave ose shërbimeve në kushte jashtëzakonisht të favorshme që shfaqen në një kohë të shkurtër. Kjo dispozitë zbatohet në rastet e shitjeve jo të zakonshme nga persona juridikë ose fizikë të cilët normalisht nuk janë furnizues. Kjo dispozitë nuk gjen zbatim për prokurimet e zakonshme nga ofertues të rregullt; Një proces i tillë shoqërohet me një memo sqaruese nga njëسيا kërkuese përmes zëvendësguvernatorit të shtyllës përkatëse.

3.10. Për nevoja urgjente në raste të situatave emergjente për furnizime, punë ose për shërbime, situata këto të shkaktuara nga rrethana jashtë kontrollit të Bankës Qendrore dhe kur koha në dispozicion për zgjidhjen e nevojës urgjente nuk është e mjaftueshme për zhvillimin normal të procedurave të tjera të prokurimit, të përcaktuara në këtë Rregull. Me kusht që kjo dispozitë të mos mund të shfrytëzohet nëse rrethanat që e kanë krijuar situatën emergjente ekstreme mund t'u atribuohen veprimeve të neglizhencës ose të qëllimita; Një proces i tillë shoqërohet me një memo sqaruese nga njëسيا kërkuese përmes zëvendësguvernatorit të shtyllës përkatëse.

3.11. Në rastet specifike në funksion të detyrës për furnizim të ekonomisë me para të gatshme, përkatësisht trajtimit të parasë së gatshme – keshit, kur për qëllim të automatizimit të proceseve të menaxhimit dhe trajtimit të parave të gatshme, Banka Qendrore mund të hyjë në marrëdhënie direkte kontraktuale me kompanitë evropiane me renome ndërkombëtare të aprovuara nga Banka Qendrore Evropiane dhe autorizuara (CE) nga Bashkimi Evropian (*që janë dëshmuar si partnere të besueshme të shumicës së bankave qendrore në botë*), të cilat merren me dizajnimin, prodhimin e valutave dhe ofrojnë zgjidhje gjithëpërfshirëse tekniko-teknologjike në tërë ciklin e parave të gatshme duke përfshirë këtu zgjidhjet tërësisht të automatizuara të trajtimit (procesimit dhe paketimit) të parave të gatshme. Për këtë qëllim dhe me qëllim të transparencës dhe efikasitetit, krijohet grup

punues që merret me procedurat e negocimit dhe dakordimit me shkrim të termave përkatëse për zbatim të këtij procesi.

3.12. Kur një procedurë e tillë, përjashtimisht nga rastet e mësipërme, një proces i tillë shoqërohet me një memo sqaruese dhe miratohet me shkrim nga Guvernatori;

4. Divizioni i Prokurimit dhe Kontraktimit, për zbatimin e procedurës së negociuar pa publikim sipas paragrafëve 3.3, 3.4 dhe 3.5 të këtij neni, bazohet në çdo rast në raportin me shkrim të menaxherit të kontratës, nëse kontrata është zbatuar në mënyrë të kënaqshme dhe gjithashtu në autorizimin e nevojshëm sipas paragrafëve 1.1 dhe 1.2 të këtij neni.

5. Zbatimi i kësaj procedure në asnjë rast nuk e liron Bankën Qendrore nga detyrimi që (i) të luajë një rol aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratës, veçanërisht sa ka të bëjë me çmimet, afatet e pranimit, sasinë, karakteristikat teknike dhe garancionet, (ii) të sigurojë që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi përkatës i tregut, si dhe (iii) të vlerësojë me kujdes kualitetin e produktit, shërbimit ose punës se realizuar me këtë procedurë.

Neni 16

Kontratat kornizë

1. Banka Qendrore mund të shfrytëzojë kontratën kornizë në rastet kur lidh rregullisht kontrata për furnizime, shërbime apo punë të ngjashme pa qenë në gjendje të definojë sasinë dhe kohën e saktë të dorëzimit dhe/apo kërkesat e hollësishme. Në këto raste, sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative dhe nuk përbën obligim ligjor për BQK-në dhe as të drejtë për kontraktuesin. Kjo dispozitë përfshihet edhe në kontratën kornizë dhe dokumentet tenderuese. Banka Qendrore do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë ndryshim të kufizuar duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Ndryshimi i lejuar nuk mund të jetë më i lartë se 30% (tridhjetë për qind). Nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë duke përfshirë edhe tridhjetë për qind (30%) e lejuar, pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të marrëveshjes kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht.

2. Me qëllim të lidhjes së një kontrate që paraqet marrëveshje kornizë, Banka Qendrore ndjek procedurën e hapur, të kufizuar apo konkurruese me negocim, sipas kësaj Rregulle për të gjitha fazat deri në arritjen e marrëveshjes kornizë. Pas lidhjes së saj dhe gjatë kohës së realizimit, kushtet e marrëveshjes kornizë nuk mund të ndryshojnë.

3. Kontratat në kuadër të marrëveshjes kornizë mund të lidhen me një ose disa operatorë ekonomikë, me kohëzgjatje në pajtim me nenin 43 të kësaj Rregulle.

4. Kur një marrëveshje kornizë lidhet me një operator ekonomik të vetëm, kontrata e bazuar në atë marrëveshje jepet brenda kufijve të kushteve të caktuara në marrëveshjen kornizë sipas së cilës realizohen edhe porositë. Në këtë rast, Banka Qendrore realizon porositë e saj sipas kontratës nga marrëveshja kornizë me operatorin ekonomik fitues.

5. Në rastet kur Banka Qendrore vendos të lidhë kontratë kornizë me disa operatorë ekonomikë, duhet të plotësohet kriteri prej së paku dy kontratave me dy operatorë të ndryshëm. Njoftimi për kontratë specifikon kriterin e dhënies që do të përdoret për mini-tenderë, fushëveprimin dhe numrin e kontratave që do të jepen. Kontratat e bazuara në marrëveshjen kornizë jepen në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë nen. Në këtë rast, vetëm operatorët ekonomikë që janë palë të kontratës kornize mund të marrin pjesë në mini-tender, për dorëzimin e të cilëve Banka Qendrore do t'iu jep afat së paku 5 (pesë) ditë nga njoftimi përkatës i saj. Në rast se jo të gjithë operatorët ekonomikë që janë palë të marrëveshjes kornizë dorëzojnë ofertat e tyre, procedura e mini-tenderimit do të jetë e vlefshme. Kontrata në mini-tender shpërblehet sipas kriterit të përcaktuar në njoftimin për kontratë siç përcaktohet në këtë paragraf.

6. Kur Banka Qendrore lidh marrëveshje kornizë me disa operatorë ekonomikë, kontratat mund të jepen ose:

6.1. Nëpërmjet zbatimit të kritereve të caktuara në marrëveshjen kornizës pa rihapur konkurrencën; ose

6.2. Nëse kriteret e tilla nuk janë të definuara, Banka Qendrore mund të rihapë konkurrencën për furnizuesit me të cilët ekziston marrëveshja kornizë.

7. Në rastin e fundit sipas nën-paragrafit 6.2 te këtij neni, Banka Qendrore jep kontratën në përputhje me procedurat e mëposhtme:

7.1. Banka Qendrore i fton operatorët ekonomikë palë të marrëveshjes kornizë që brenda një afati prej 5 (pese) ditësh të paraqesin tenderët. Kërkesa për propozim gjithashtu duhet të specifikojë kriteret në bazë të të cilave do të jepen kontratat;

7.2. Tenderuesit duhet t'i paraqesin tenderët e tyre me shkrim brenda afatit të caktuar nga Banka Qendrore, dhe

7.3. Banka Qendrore ia jep kontratën tenderuesit i cili ka paraqitur tenderin më të mirë në bazë të kritereve për dhënie të caktuara në kërkesën për propozim.

Neni 17

Sistemi prokurues/blerës dinamik

1. Banka Qendrore mund të prokurojë mallrat, shërbimet dhe punët për shfrytëzim të zakonshëm nëpërmjet sistemeve blerëse dinamike. Përveç nëse specifikohet ndryshe në këtë nen, Banka Qendrore ndjek dhe zbaton rregullat e procedurës së hapur.

2. Për qëllime të krijimit të një sistemi blerës dinamik, Banka Qendrore:

2.1. Publikon njoftimin për kontratë që tregon se është shfrytëzuar sistemi blerës dinamik dhe përmban referencën në adresën e internetit ku mund të gjenden kushtet e tenderit;

2.2. Ofron me anë të mjeteve elektronike pas publikimit të njoftimit dhe deri në skadimin e sistemit, qasje të pakufizuar, të drejtpërdrejtë dhe të plotë në kushtet e tenderit dhe në çdo dokument shtesë;

2.3. Cakton kushtet e tenderit në mes çështjeve të tjera, kriteret për përzgjedhje dhe dhënie, natyrën e blerjes së paraparë sipas atij sistemi, si dhe të gjitha informatat lidhur me sistemin blerës, pajisjet elektronike të shfrytëzuara dhe marrëveshjet për lidhje teknike dhe specifikime.

3. Sistemi është i hapur gjatë gjithë kohëzgjatjes së tij për çdo furnizues, që plotëson kriteret e përzgjedhjes dhe që ka paraqitur një tender shprehës në pajtim me kushtet e tenderit. Tenderuesit mund t'i përmirësojnë tenderët e tyre indikativë në çdo kohë, me kusht që ata vazhdojnë t'u përmbahen kushteve të tenderit.

4. Pas pranimit të tenderëve indikativë, Banka Qendrore verifikon brenda një kohe të arsyeshme përshtatshmërinë e tenderuesve dhe përmbushjen e kriterëve të përzgjedhjes. Po ashtu kontrollon nëse tenderët indikativë i plotësojnë kushtet e tenderit. Banka Qendrore njofton tenderuesit në kohë sa më të shkurtër lidhur me pranimin në sistemin blerës dinamik apo për mospranimin e tyre.

5. Çdo kontratë specifike vlera e së cilës është mbi pragjet e përcaktuara në nenin 19 të kësaj Rregulle i nënshtrohet ftesës së veçantë për tender. Para lëshimit të kësaj ftese, Banka Qendrore publikon një njoftimin për kontratë në një gazetë kombëtare me tirazh më të madh në vend duke i ftuar të gjithë tenderuesit e interesuar, që ta paraqesin tenderin indikativë brenda një afati që nuk mund të jetë më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita kur është dërguar njoftimi. Banka Qendrore fillimisht bën vlerësimin e të gjithë tenderëve indikativë të pranuar deri në afatin e caktuar dhe pastaj vazhdon me tenderim.

6. Pas përfundimit të vlerësimit, Banka Qendrore i fton të gjithë tenderuesit e pranuar në sistem që ta paraqesin tenderin brenda një kohe të arsyeshme. Banka Qendrore ia jep kontratën tenderuesit, i cili ka paraqitur tenderin më të mirë në bazë të kriterëve për dhënie të përcaktuara në njoftimin për kontratë për krijimin e sistemit blerës dinamik. Këto kritere sipas nevojës mund të formulohen më saktësisht në ftesën për tender.

7. Nëse vlera e një kontrate specifike është nën pragjet e nenit 18 të kësaj Rregulle, Banka Qendrore mund t'i ftojë pesë (5) apo tre (3) tenderues të pranuar në sistem në përputhje me procedurën e caktuar në nenin 45 të kësaj Rregulle.

8. Një sistem blerës dinamik nuk mund të zgjasë më tepër se katër (4) vite, përveç në rastet e arsyetuara mirë.

KAPITULLI III

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA PËR TË GJITHA PROCEDURAT E PROKURIMIT

Neni 18

Llogaritja e vlerës së parashikuar të kontratës

1. Llogaritja e vlerës së një kontrate bazohet në shumën e përgjithshme duke përfshirë të gjitha taksat dhe tatimet e aplikueshme. Llogaritja përfshin kostot e ndërlidhura, në veçanti kostot lidhur me pikat alternative, përtëritjet e kontratës, pagesat e primit, normës, interesit dhe kostot e udhëtimit dhe akomodimit, çmimet apo pagesat për kandidatët ose tenderuesit.
2. Vlerësimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin që Banka Qendrore vendos për procedurën e duhur të prokurimit.
3. Asnjë prokurim nuk mund të ndahet me qëllim të shmangies së zbatimit të procedurave të përcaktuara sipas kësaj Rregulle.
4. Llogaritja e vlerës së paraparë të kontratave për punë merr për bazë kostot e përgjithshme lidhur me ekzekutimin e punëve duke përfshirë vlerën e furnizimeve të nevojshme për ekzekutimin e punëve, të cilat vihen në dispozicion të kontraktuesit nga Banka Qendrore. Kostot që lidhen me dizajnin dhe planifikimin e punëve do të llogariten gjithashtu si pjesë e vlerës së paraparë të kontratave për punë.
5. Sa i përket kontratave për furnizim të vazhdueshëm me mallra dhe shërbime, vlera që merret për bazë për llogaritjen e vlerës së paraparë të kontratës, sipas nevojës është si në vijim:
 - 5.1. Në rast të kontratave me afat të caktuar: vlera e përgjithshme për tërë afatin;
 - 5.2. Në rast të kontratave pa afat të caktuar: vlera mujore e shumëzuar me dyzet e tetë (48).
6. Në rast të kontratave pasuese për furnizim, shërbime, dhe punë të të njëjtit lloj, llogaritja e vlerës së paraparë të kontratës bazohet në vlerën aktuale të kontratave pasuese të dhëna gjatë dymbëdhjetë (12) muajve paraprakë. Llogaritja përshtatet nëse është e mundshme, duke marrë parasysh ndryshimet në sasi apo në vlerë të cilat priten të ndodhin gjatë dymbëdhjetë (12) muajve pas kontratës fillestare.
7. Nëse kontrata ndahet në disa pjesë, apo nëse disa kontrata që jepen janë për së tepërmi të ndërlidhura dhe për objektivat e tyre kanë detyra të njëjta, atëherë konsiderohet vlera e përgjithshme e të gjitha pjesëve apo kontratat individuale.
8. Vlera e marrëveshjeve kornizë llogaritet në bazë të vlerës së përgjithshme maksimale të përlllogaritur të të gjitha kontratave të parapara për afatin e përgjithshëm të marrëveshjes kornizë.

Neni 19

Klasifikimi i kontratave sipas vlerës

1. Kontratat vlera e përgjithshme e përllogaritur e të cilave është e barabartë ose tejkalon shumat e pragut të caktuar në paragrafin 3 të këtij neni, tenderohen në përputhje me procedurat e përcaktuara në Kapitullin II të kësaj Rregulle.
2. Kontratat vlera e përgjithshme e përllogaritur e të cilave është nën shumat e pragut të caktuara në paragrafin 3 të këtij neni, tenderohen në përputhje me procedurat e përcaktuara sipas neneve 13 dhe 14 të kësaj Rregulle.
3. Shumat e pragut të cilat zbatohen janë sipas përcaktimeve në vijim:
 - 3.1. Për kontratat për furnizim dhe shërbime pragu i lartë është pesëmbëdhjetë mijë (15,000) euro,
 - 3.2. Për kontratat për punë pragu i lartë është tridhjetë mijë (30,000) euro.
4. Klasifikimi i kontratave sipas vlerës është përcaktuar si në vijim:
 - 4.1. Kontratë me vlerë minimale konsiderohet kontratat prej 1,000 (një mijë) deri në 5,000 (pesë mijë) euro.
 - 4.2. Kontratë me vlerë të vogël konsiderohen kontratat si në vijim:
 - 4.2.1. Kontratat për furnizim dhe shërbime prej 5,001 (pesë mijë e një) deri në 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro,
 - 4.2.2. Kontratat për punë prej 5,001 (pesë mijë e një) deri në 30,000 (tridhjetë mijë) euro.
 - 4.3. Kontratë me vlerë të mesme konsiderohen kontrata si në vijim:
 - 4.3.1. Kontratat për furnizim dhe shërbime prej 15,001 (pesëmbëdhjetë mijë e një) deri në 125.000 (njëqind e njëzet e pesë mijë) euro,
 - 4.3.2. Kontratat për punë prej 30,001 (tridhjetë mijë e një) deri në 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) euro.
 - 4.4. Kontratë me vlerë të madhe konsiderohen kontratat si në vijim:
 - 4.4.1. Kontratat për furnizim dhe shërbime mbi 125,000 (njëqind e njëzet e pesë mijë) euro.
 - 4.4.2. Kontratat për punë mbi 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) euro.

Neni 20

Kërkesa për prokurim

1. Çdo procedurë prokurimi fillon me paraqitjen e kërkesës në Divizionin e Prokurimit dhe Kontraktimit sipas listës së projekteve të miratuara, ku i njëjti është projekt. Kërkesa përgatitet nga njësi kërkuese dhe duhet të përmbajë të dhënat në vijim:

1.1 Kërkesat e qarta dhe të plota lidhur me objektin e prokurimit (furnizim, punë ose shërbim) që kërkohen të realizohen, të shprehura edhe nga ana sasiore dhe të shoqëruara me argumentimin përkatës nga departamenti/divizioni kërkuës me një vlerësim formal të nevojave për t'u përmbushur dhe që rezultatet e këtij vlerësimi të regjistrohen formalisht me shkrim në kërkesë dhe të ruhen si dokumentacion;

1.2. Kërkesa dhe/ose specifikimet teknike dhe funksionale të hartuara me përgjegjësi në bazë të nevojave;

1.3. Fondin e nevojshëm të planifikuar në buxhetin e vitit përkatës kalendarik për objektin e prokurimit, si dhe, për kontratat me afat më të gjatë se një vit, fondin e plotë sipas vlerës së parashikuar të kontratës për tërë periudhën e planifikuar kontraktuese;

1.4. Në rastet e kontratave afatgjate fondin e nevojshëm të planifikuar sipas buxhetit vjetor dhe një bazë të arsyeshme të parashikimit/planifikimit në mënyrë që të zotohen mjetet edhe për vitet e ardhshme fiskale përgjatë tërë periudhës së afatit të kontratës përkatëse;

1.5. Kërkesa paraqitet përmes zëvendësguvernatorit të fushës e nënshkruar nga Guvernatori apo i autorizuari/deleguari i tij.

2. Dhjetë ditë pas pranimit të kërkesës së prokurimit vazhdon shpallja e tenderit me përjashtim të rasteve të veçanta kur kërkohet shqyrtim më i hollësishëm.

Neni 21

Shpallja e prokurimit

1. Në rastet e zbatimit të një procedure të paraparë sipas nenit 10, nenit 11 dhe nenit 12 të kësaj Rregulle, Banka Qendrore publikon njoftimin për kontratë në të njëjtën datë, njëkohësisht në ueb-faqe si dhe në media elektronike zyrtare të saj. Në rast të mospërputhjes ndërmjet dy versioneve të ndryshme të shpalljes, versioni i publikuar në ueb-faqen zyrtare të Bankës Qendrore është autentik dhe mbizotëron ndaj versioneve të tjera.

2. Banka Qendrore gjithashtu mund ta publikojë një "njoftim paraprak" me informata rreth vlerës së përgjithshme të paraparë të kontratave sipas kategorisë së shërbimit apo gupeve të produkteve, dhe karakteristikat esenciale të kontratave për punë të cilat ka ndërmend t'i japë gjatë një viti buxhetor.

3. Parashikimi i vlerës së kontratës përcaktohet në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit.

Neni 22

Ftesa dhe dosja e tenderit

1. Ftesa për tender përmban së paku të dhënat në vijim:

1.1. Numrin e prokurimit/referencën në shpalljen e publikuar për kontratë;

1.2. Kërkesat formale të tenderit, në veçanti afatin për pranimin e tenderëve, adresën në të cilën duhet të dërgohen tenderët, gjuhën apo gjuhët në të cilat duhet të hartohen tenderët, formën në të cilën paraqitet tenderi dhe periudhën gjatë të cilës tenderi duhet të mbetet i vlefshëm; dhe

1.3. Opsionet lidhur me punët, shërbimet dhe furnizimet plotësuese, si dhe numrin e përsëritjeve dhe vazhdimeve të mundshme nëse ka;

1.4. Listën e dokumenteve që do të paraqiten nga tenderuesit; dhe

1.5. Peshën përkatëse që iu është dhënë kriterëve për dhënie të kontratës apo sipas nevojës, rendin e zbritjes sipas rëndësisë së kriterëve të tilla, nëse ato nuk janë dhënë në njoftimin për kontratë.

2. Dosja e tenderit përbëhet prej tri pjesëve: procedura e tenderimit, draft kontrata dhe formulari i tenderit dhe përfshin si në vijim:

2.1. Një kopje të specifikimeve sipas nenit 28 të kësaj Rregulle që definojnë kërkesat e Bankës Qendrore apo në rast të procedurës së negociuar, një kopje të kërkesës për propozim që definojnë nevojat e Bankës Qendrore; dhe

2.2. Një kopje të draft kontratës, me afatet dhe kushtet e përgjithshme;

2.3. Ndonjë dokumentacion i cili konsiderohet relevant nga Banka Qendrore. Nëse këto dokumente vihen në dispozicion me anë të mjeteve elektronike, ftesa për tender specifikon sesi tenderuesit mund të kenë qasje në to.

3. Kushtet e Ftesës së tenderit sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen për procedurat për kuotim çmimesh dhe blerje me vlerë minimale.

4. Zyrtari i prokurimit përgatit dosjen e tenderit në harmoni me dispozitat e këtij neni, bashkë me dosje, përgatit edhe kriteret e përzgjedhjes, kriterin e dhënies të cilat paraprakisht autorizohen nga udhëheqësi i divizionit të prokurimit dhe kontraktimit, ndërsa specifikimet teknike do të përgatiten nga njësitë kërkuese dhe konfirmohen nga udhëheqësi i saj, sipas kësaj Rregulle. Në raste të kontratave komplekse ose të veçanta, Banka Qendrore mund të caktojë ekspert të jashtëm ose kontraktorë, për të ndihmuar në hartimin e specifikave teknike e

funkionale. Në këto raste, Banka Qendrore zbaton dispozitat e kësaj Rregulle për angazhimin e eksperteve të jashtëm ose kontraktorëve.

Neni 23

Numërtimi i Prokurimit

1. Çdo aktivitet i prokurimit duhet të kodohet nga Banka Qendrore me "numër të prokurimit" për një identifikim të shpejtë dhe për qëllime të monitorimit, për qëllime statistikore, etj.

2. Numri i Prokurimit përbëhet prej:

Tabela nr.1.

Numri i Prokurimit	
1	Identifikimi i Bankës Qendrore
2	Identifikimi i vitit të prokurimit
3	Numri serik prej 3 shifrave duke rifilluar me 001 secilin vit kalendarik
4	Kodi treshifror për llojin, vlerën dhe procedurën e prokurimit

3. Kodi për llojin e prokurimit është i paraqitur në tabelën në vijim:

Tabela nr.2.

Kodi për llojin e prokurimit	
1	Furnizim
2	Shërbime
3	Punë

4. Kodi për vlerën e prokurimit është si në tabelën në vijim:

Tabela nr.3.

Kodi për vlerën e prokurimit	
1	Vlerë e madhe
2	Vlerë e mesme
3	Vlerë e vogël
4	Vlerë minimale

5. Kodi për procedurën e prokurimit është si në vijim:

Tabela nr.4.

Kodi për procedurën e prokurimit	
1	Procedurë të hapur
2	Procedurë të kufizuar
3	Procedurë konkurruese me negociim
4	Procedurë për kuotimin e çmimeve
5	Procedurë për blerjen me vlerë minimale
6	Procedurë e negociuar pa publikim

Neni 24

Komunikimi me kandidatët dhe tenderuesit

1. Gjatë procedurës së tenderimit, kandidatët dhe tenderuesit komunikojnë vetëm me personat kontaktues të caktuar nga Banka Qendrore. Banka Qendrore në njoftimin për kontratë dhe/apo në ftesën për tender specifikon mjetet që do të shfrytëzohen për komunikim. Mjetet e komunikimit në përgjithësi janë të disponueshme dhe jodiskriminuese. Komunikimi i paautorizuar nga stafi i BQK-së trajtohet si tejkalim kompetence ose çështje disiplinore dhe adresohet në pajtim me Politikën e Marrëdhënies së Punës në BQK dhe Kodin e Etikes dhe Mirësjelljes në BQK.
2. Kandidatët/tenderuesit i paraqesin kërkesat/tenderët e tyre me shkrim në përputhje me kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë/ftesën për tender.
3. Banka Qendrore mund t'i zbatojë procedurat e tenderimit elektronik, kur një mundësi e tillë zhvillohet. Në rast të tillë, njoftimi për kontratë specifikon në veçanti kërkesat formale që duhet të plotësohen nga kandidatët/tenderuesit dhe tregon si të qasën në platformën elektronike. Banka Qendrore mund të përcaktojë se pranon vetëm kërkesat/tenderët elektronik.
4. Kandidatët/tenderuesit mund t'ia parashtrorjnë Bankës Qendrore me shkrim pyetjet e tyre lidhur me njoftimin për kontratë, ftesën për tender apo dokumentet mbështetëse në përputhje me kushtet e caktuara në njoftimin për kontratë apo në ftesën për tender. Banka Qendrore iu përgjigjet pyetjeve të tilla brenda afateve të arsyeshme dhe ua komunikon përgjigjet të gjithë kandidatëve/ tenderuesve në mënyrë anonime nëse ato kanë lidhje me ta.
5. Banka Qendrore siguron se informatat e ofruara nga kandidatët dhe tenderuesit trajtohen dhe ruhen në përputhje me parimin e konfidencialitetit.

Neni 25

Afatet për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje dhe për pranimin e tenderëve

1. Gjatë caktimit të afateve për pranimin e tenderëve dhe kërkesave për pjesëmarrje, Banka Qendrore merr parasysh në veçanti kompleksitetin e kontratës dhe kohën e nevojshme për hartimin e tenderëve, pa paragjykuar në afatet minimale të caktuara nga ky nen.
2. Në rast të procedurave të hapura, afati minimal për pranim të tenderëve është dhjetë (10) ditë nga data e dërgimit të njoftimit për kontratë.
3. Në rast të procedurave të kufizuara, procedurave të negociuara:
 - 3.1. afati minimal për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje është dhjetë (10) ditë nga dita e dërgimit të njoftimit për kontratë; dhe
 - 3.2. afati minimal për pranimin e tenderëve është dhjetë (10) ditë nga data e dërgimit të njoftimit për kontratë.

4. Afatet për pranimin e tenderëve mund të shkurtohen për pesë (5) ditë nëse Banka Qendrore ofron arsyetim të mjaftueshëm si dhe merr aprovimin paraprak nga Guvernatori.

5. Nëse në një procedurë të hapur, ftesa për tender ndonëse e kërkuar me kohë, nuk jepet brenda gjashtë (6) ditëve, apo kur tenderët mund të paraqiten vetëm pas vizitës në vend apo pas inspektimit në vend të dokumenteve që mbështesin ftesën për tender, afatet për pranimin e tenderëve mund të vazhdojnë me qëllim që të gjithë operatorët ekonomikë të kenë kohë për përgatitje të tenderëve.

6. Në rast të procedurave të kufizuara dhe procedurave të negociuara, Banka Qendrore mund të zbatojë një procedurë të përshpejtuar ku nevoja urgjente i shihet jopraktike afatet e caktuara në këtë nen. Në një rast të tillë do të zbatohen afatet minimale si në vijim:

6.1. Afati për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje i cili nuk mund të jetë më pak se pesë (5) ditë nga data e dërgimit të njoftimit për kontratë;

6.2. Afati për pranimin e tenderëve i cili nuk mund të jetë më pak se pesë (5) ditë nga data e pranimit të ftesës për tender.

7. Para datës së skadimit, Banka Qendrore mund të vazhdojë afatet e caktuara në njoftimin për kontratë apo dokumentacionin e tenderit nëse modifikon dokumentacionin e tenderit apo në raste të tjera të arsyetuara mirë.

Neni 26

Kërkesat për informata shtesë dhe sqarime

1. Pas hapjes së kërkesave për pjesëmarrje apo tenderëve, në fazën e vlerësimit, Banka Qendrore mund t'iu kërkojë kandidatëve ose tenderuesve që brenda një afati të caktuar kohor të paraqesin informacion apo dokumentacion shtesë, sqarues, apo plotësues i cili mungon plotësisht apo duket të jetë i mangët, ose është i gabuar në aplikacionet respektivisht në tenderët e dorëzuar. Të gjithë pjesëmarrësve iu ofrohet kjo mundësi kur aplikohet.

2. Kërkesat për informata shtesë dhe sqarime bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës, në mënyrë të veçantë nuk duhet të çojë në ndonjë trajtim preferencial, apo të japin avantazh konkurrues, ose të ndryshojnë kushtet e një aplikimi ose tenderi.

3. Në njoftimin për kontratë, respektivisht në dosjen e secilit tender Banka Qendrore specifikon se për cilat kategori të dokumentacionit mund të kërkohen informata apo plotësime shtesë nga kandidatët respektivisht tenderuesit.

4. Kërkesa nga Banka Qendrore për informata shtesë dhe sqarime sipas këtij neni do të aplikohet vetëm për dokumentet të cilat kandidatet ose tenderuesit i posedojnë (ekzistenca e të cilave është e fiksuar) para afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Neni 27

Korrigjimi i dokumentacionit të tenderit

1. Nëse Banka Qendrore zbulon, para skadimit të afateve për paraqitjen e kërkesave apo tenderëve, ndonjë gabim, ndonjë mungesë saktësie, ndonjë lëshim apo ndonjë lloj gabimi në tekstin e njoftimit për kontratë, ftesën për tender apo dokumentet përcjellëse, ajo e korrigjon gabimin dhe i njofton të gjithë kandidatët apo tenderuesit në mënyrë të duhur.

2. Nëse kandidatët apo tenderuesit konsiderojnë se kërkesat e Bankës Qendrore të caktuara në njoftimin për kontratë, ftesën për tender apo dokumentet mbështetëse janë të pakompletuara, kontradiktore apo jologjore, ata njoftojnë menjëherë me shkrim Bankën Qendrore lidhur me shqetësimet e tyre. Kandidati/tenderuesi duhet të njoftojë për shqetësimet e tij pa vonesë të tepërt pasi që të jetë në dijeni të parregullsisë apo pasi që të ketë mundur të dijë për to. Banka Qendrore pastaj mund që t'i korrigjojë apo plotësojë kërkesat ashtu siç kërkohet ose të kundërshtojë kërkesën duke dhënë arsyet lidhur me këtë. Kundërshtimet ndaj kërkesave të Bankës Qendrore të cilat nuk i janë komunikuar kësaj të fundit pa vonesë të tepërt nuk mund të ngritën në një fazë të mëvonshme.

Neni 28

Specifikimet teknike

1. Banka Qendrore parashtron në dosjen e tenderit të gjitha specifikimet teknike me të cilat duhet të jetë në pajtueshmëri çdo tender. Njësia kërkuese e Bankës Qendrore përpilon specifikimet teknike, në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit, jodiskriminuese dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë kandidatët dhe tenderuesit. Gjithashtu, njësia kërkuese specifikon nëse specifikimet teknike janë obligative apo kërkesa minimale. Të njëjtat konfirmohen nga udhëheqësi më i lartë i njësisë dhe zëvendësguvernatori i shtyllës përkatëse.

2. Kur specifikimet teknike janë kërkesa obligative, të gjithë tenderët duhet t'i përmbushin në mënyrë që të konsiderohen tenderë të përgjegjshëm.

3. Nëse për dhënien e një kontrate aplikohet kriteri tenderi ekonomikisht më i favorshëm, specifikimet teknike përveç kërkesave obligative mund të përmbajnë kërkesa të preferuara funksionale (performancës), kualitetit, qëndrueshmërisë, garancisë, etj., dhe mbi të cilat tenderuesit vlerësohen. Specifikimet teknike të tilla mund të përcaktohen si nën-kritere ("karakteristikat funksionale") për tenderin ekonomikisht më të favorshëm.

4. Gjate formulimit të specifikimeve teknike, njësia kërkuese mund t'i referohet:

- 4.1 një standardi të Kosovës që implementon një standard Evropian;
- 4.2 një standardi Evropian;
- 4.3 një miratimi teknik Evropian,
- 4.4 një specifikimi të përbashkët teknik,
- 4.5 një standardi ndërkombëtar apo

4.6 çfarëdo referimi tjetër teknik të nxjerrë nga organet Evropiane për standardizim.

5. Në përgjithësi, nuk duhet të ketë asnjë kërkesë ose referencë për specifikimet teknike të markës ose emrit, të patentës, të vizatimit a të tipit, të origjinës së prodhuesit ose të dhënësit të shërbimit. Përfundimisht, në raste të veçanta, njësi kërkuese mund të hartojë specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni me kusht që çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët “ose ekuivalent”.

6. Njësi kërkuese sipas objektit konkret të prokurimit, duke gjykuar dhe argumentuar vet rëndësinë, natyrën e punës, kushtet teknike apo specifike tepër të veçanta të mallit ose shërbimit të kërkuar apo ekzistencën e një strategjie apo politike të miratuar nga Banka Qendrore, dhe mbështetur sipas rastit në argumentimet e bëra në kërkesën për prokurim të departamentit përkatës, mund të përcaktojë markat e mallrave, qoftë si kategori “*brand name*” qoftë si markë e individualizuar, duke marrë në çdo rast aprovimin me shkrim nga Guvernatori, pas rekomandimit nga zëvendësguvernatori i shtyllës përkatëse. Në prokurimin e mallrave dhe shërbimeve me markë të individualizuar, njësi kërkuese synon të prokurojë direkt me prodhuesin ose sipas njoftimit të këtij të fundit, me përfaqësuesin e autorizuar të tij.

7. Banka Qendrore, mund të specifikojë funksione të preferuara, performancë apo specifikime të tjera, si nënkritere, mbi të cilat tenderuesit vlerësohen për tenderin ekonomikisht më të favorshëm sipas nenit 29 të kësaj Rregulle.

8. Në raste të veçanta për hartimin e specifikimeve teknike mund të merren edhe specialistë nga jashtë Bankës Qendrore kundrejt shpërblimit përkatës.

9. Njësi kërkuese është përgjegjëse që të përpilojë specifikimet teknike në pajtim me kërkesat e kësaj Rregulle. Njësi kërkuese do të dorëzojë pranë Divizionit të Prokurimit dhe Kontraktimit Deklaratën si formular standard për specifikimet teknike dhe funksionale të hartuara.

10. Banka Qendrore duhet të sigurohet se furnizimet, shërbimet dhe prodhues të ndryshëm nuk u takojnë vendeve (shteteve) për të cilat Republika e Kosovës mund të ketë vendosur sanksione në import/eksport, ose vendeve, prodhimet, shërbimet dhe furnizimet e të cilave konsiderohen si të pabesueshme nga ndonjëra prej organizatave/vendeve, siç janë: Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, NATO, OECD ose Shoqata Evropiane për Tregti të Lirë.

Neni 29

Variantet e specifikimeve teknike

1. Në rastet e prokurimeve ku Banka Qendrore aplikon kriterin e tenderit ekonomikisht më të favorshëm, ajo mund të autorizojë ofertuesit që të paraqesin variante të specifikave teknike.

Kjo informatë u bëhet e ditur kandidatëve apo tenderuesve në njoftimin për kontratë respektivisht në dosjen e tenderit.

2. Në rastet e tilla të lejimit të varianteve, Banka Qendrore paraqet në dosjen e tenderit kërkesat minimale të specifikimeve teknike për t'u plotësuar nga variantet. Vetëm variantet që i përmbushin këto kërkesa minimale të përcaktuara do të pranohen nga Banka Qendrore.

3. Për shkak të rëndësisë së inovacionit dhe zhvillimeve teknologjike të produkteve e shërbimeve, Banka Qendrore inkurajohet që të aplikojë variantet sa më shpesh që të jetë e mundur. Në këtë mënyrë, përmes kriterit të tenderit ekonomikisht më të favorshëm, duke e vlerësuar me më shumë pikë nënkriterin e caktuar të specifikacionit teknik të ofruar nga një tenderues si variant më i mirë krahasuar me kërkesat minimale të caktuara, Banka Qendrore siguron ekonomikitetin dhe efikasitetin më të madh nga një procedurë e prokurimit ku janë aplikuar variantet.

Neni 30 **Sigurimi i tenderit**

1. Banka Qendrore mund të përfshijë në dokumentet e tenderit kushtin e sigurimit të tenderit (ofertës) në formën e garancisë bankare, letër krediti apo policës së sigurimit. Vlera e sigurimit të tenderit duhet të jetë jo më pak se 3 % (tre për qind) dhe jo me shume se 5% (pesë për qind) e vlerës së parashikuar të kontratës, dhe në asnjë rast nuk mund të jetë më pak se një mijë (1.000) euro. Kushti i sigurimit të tenderit është i detyrueshëm në rast se këtë e kërkon Banka Qendrore për procedurën e hapur dhe të kufizuar dhe duhet të dorëzohet bashkë me ofertë. Banka Qendrore, në varësi të objektit konkret të prokurimit, mund ta parashikojë këtë kusht edhe për procedura të tjera të prokurimit.

2. Sigurimi i tenderit konfiskohet nga Banka Qendrore, në rast se:

- 2.1. Një ofertues tërheq ofertën e tij brenda periudhës së vlefshmërisë së ofertës;
- 2.2. Një ofertues fitues heq dorë nga lidhja e kontratës ose nuk është në gjendje të japë sigurimin e përmbushjes së detyrimeve të kontratës, në qoftë se kërkohet një sigurim i tillë;
- 2.3. Posedon fakte të verifikuara se tenderuesi në fjalë i ka dhënë Bankës Qendrore informacione përmbajtësisht të gabueshme ose mashtruese në ofertën e tij.

3. Nëse nuk ka ndodhur ngjarja që mund të shkaktojë konfiskimin e sigurisë së ofertës, Banka Qendrore me kërkesë të tenderuesit ia kthen fondet ose dokumentet që janë depozituar në formë të sigurisë së ofertës, në përputhshmëri me kushtet e tenderit përkatës.

4. Nëse Banka Qendrore konstaton se ka ndodhur një ngjarje që kërkon konfiskimin e sigurisë së tenderit sipas paragrafit 2 të këtij neni, e njofton tenderuesin përkatës me shkrim për zbatim të konfiskimit. Sidoqoftë, nëse sigurimi i tenderit në fjalë është deponuar në formë kredie ose sigurie bankare, Banka Qendrore duhet që së pari të marrë të gjitha masat e nevojshme për t'i

marrë fondet përkatëse nga lëshuesi i tyre para se t'i dërgojë tenderuesit njoftimin e kërkuar sipas këtij paragrafi. Fondet e tilla të deponuara nuk mund të shfrytëzohen përderisa tenderuesi përkatës të ketë shteruar të drejtën e tij për të apeluar kundër vendimit të Bankës Qendrore për konfiskim të sigurimit të tenderit.

5. Pasi që tenderuesi t'i ketë shteruar të drejtat e tij brenda afatit prej 5 ditë pune për të apeluar kundër njoftimit sipas paragrafit 4 të këtij neni, sipas vendimit të Bankës Qendrore mbi ankesën, do ta trajtojë konfiskimin e depozitit të tillë të sigurimit të tenderit. Në rast të konfiskimit të sigurimit, fondet do të transferohen në xhirollogarinë e përgjithshme rrjedhëse të Bankës Qendrore.

Neni 31

Përshtatshmëria e kandidatëve/tenderuesve

1. Të gjithë personat fizikë dhe juridikë që janë banorë apo gjenden në Republikën e Kosovës kanë të drejtë pjesëmarrje në procedurat e prokurimit të Bankës Qendrore. Procedurat e tenderit gjithashtu janë të hapura sipas kushteve të barabarta për të gjithë personat fizikë dhe juridikë që nuk janë banorë të Republikës së Kosovës apo vijnë nga vendet e tjera. Operatorët ekonomikë nga vendet e tjera mund të pranohen që të marrin pjesë sipas përzgjedhjes së plotë të Bankës Qendrore.

2. Grupet e përkohshme të partneritetit mund të marrin pjesë në një procedurë për tender sipas kushteve të caktuara në njoftimin për kontratë apo në ftesën për tender. Banka Qendrore mund të kërkojë nga grupet e tilla që të miratojnë një formë specifike ligjore nëse kontrata iu jepet atyre, nëse kjo formë është e nevojshme për përmbushjen e duhur të kontratës.

3. Banka Qendrore përjashton kandidatët apo tenderuesit nga pjesëmarrja në një procedurë për tender nëse në 10 vitet e fundit kanë qenë objekt i ndonjë aktgjykimi të formës së prerë për vepër penale mashtrim, korrupsion, shpërlaje parash, përfshirje në organizata kriminale apo në ndonjë aktivitet tjetër ilegal që dëmton interesat financiare të vendit dhe Bankës Qendrore.

4. Banka Qendrore mund t'i refuzojë dhe/ose përjashtojë kandidatët apo tenderuesit nga pjesëmarrja në procedurat e saj të prokurimit në çdo kohë nëse ata:

4.1. Kanë falimentuar apo janë në likuidim, punët e tyre administrohen nga gjykatat, kanë hyrë në marrëveshje me kreditorët, kanë ndërprerë aktivitet afariste, janë objekt i procedurës lidhur me këto çështje, apo ndodhen në situatë të ngjashme si rrjedhojë e procedurës së njëjtë të paraparë në kornizën ligjore të vendit;

4.2. Është konstatuar nga një gjykatë kompetente, agjenci administrative ose organizatë për zbatimin e standardeve të sjelljes profesionale, se është sjellë në mënyrë joprofesionale apo ka bërë shkelje serioze profesionale;

- 4.3. Nuk i kanë përmbushur obligimet e tyre lidhur me pagesën e kontributeve pensionale, shëndetësore apo pagesën e taksave në përputhje me dispozitat ligjore të vendit në të cilin janë themeluar apo ato selisë së Bankës Qendrore apo ato të vendit ku përmbushet kontrata.
- 4.4. Janë shpallur nga një gjykatë apo (arbitrazh) se kanë bërë shkelje serioze të kontratës si dështim për t'iu përmbajtur obligimeve të tyre kontraktuese pas një procedurë tjetër të tenderimit;
- 4.5. Drejtuesit, personeli apo ndërmjetësit e tyre kanë konflikt të interesit;
- 4.6. Janë përgjegjës për shpërdorim në ofrimin e informatave të kërkuara nga Banka Qendrore;
- 4.7. Kanë kontaktuar kandidatët apo tenderuesit e tjerë me qëllim të kufizimit të konkurrencës;
- 4.8. Kanë qenë pjesëmarrës në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit, ose në përgatitjen e ndonjë pjese të tyre përfshirë specifikimet teknike,
- 4.9. Nuk janë më të autorizuar nga autorizuesit fillestar për furnizime, punë e shërbime specifike që kanë qenë kritere profesionale e teknike të tenderimit.
5. Kandidatët apo tenderuesit duhet të vërtetojnë se ata nuk gjenden në ndonjërin nga situatat e lartpërmendura dhe/apo t'i ofrojnë dëshmitë e specifikuar në njoftimin për kontratë apo në ftesën për tender. Nëse ngritën rrethana të tilla gjatë procedurës, kandidati/tenderuesi përkatës e njofton Bankën Qendrore pa vonesë lidhur me këtë.

Neni 32 **Kriteret e përzgjedhjes**

1. Banka Qendrore specifikon në njoftimin për kontratë si dhe në dosjen e tenderit kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve/tenderuesve për të përmbushur kontratën. Kriteret e përzgjedhjes kanë të bëjnë me kapacitetin ekonomik, financiar, teknik apo profesional të kandidatit apo tenderuesit.
2. Banka Qendrore cakton nivelet minimale të kapacitetit nën të cilat nuk mund t'i përzgjedhë kandidatët apo tenderuesit. Këto nivele minimale specifikohen në njoftimin për kontratë si dhe në ftesën për tender si kritere për kualifikim.
3. Banka Qendrore, me qëllim të vlerësimit të përshtatshmërisë profesionale mund të kërkojë nga kandidatët apo tenderuesit që të dëshmojnë se janë të autorizuar ta përmbushin kontratën sipas ligjeve vendore, që evidentohet nëpërmjet përfshirjes në regjistrin tregtar apo profesional apo në deklaratën ose certifikatën e betimit, anëtarësisë së organizatës specifike, autorizimit të qartë etj.

4. Banka Qendrore specifikon në njoftimin për kontratë dhe/apo në ftesën për tender dokumentet që duhet të dorëzohen nga kandidatët apo tenderuesit si dëshmi e kapacitetit të tyre financiar, ekonomik, teknik dhe profesional. Dokumentacioni i kërkuar nuk shkon përtej objektit të kontratës dhe merr parasysh interesat legjitime të operatorëve ekonomikë për sa i përket veçanërisht mbrojtjes së sekreteve të tyre afariste dhe teknike.

4.1 Sa i përket kapacitetit teknik e profesional, Banka Qendrore mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës, si vijon:

4.1.1. Në rastin e furnizimeve:

- listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e kaluara, duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit: kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë si dhe referenca; kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë si dhe referenca;

- përshkrimin e pajisjeve teknike të operatorit ekonomik, masave të sigurimit të cilësisë dhe pajisjeve për zhvillim që mund të kërkohen;

- mostrat e produktit, përshkrimeve, prezantimeve grafike dhe/ose fotografive të produkteve që duhet të furnizohen.

4.1.2. Në varësi të llojit të shërbimeve mund të kërkohen dëshmi me të cilat dëshmohet aftësia e operatorëve ekonomikë për sigurimin e shërbimeve, si shkathtësitë, efikasiteti, kapaciteti, përvoja dhe besueshmëria.

4.1.2.1 Të dhënat përkitazi me aftësitë teknike të operatorëve ekonomikë mund të parashtrihen përmes një ose më shumë mjeteve në vijim, sipas llojit, sasisë dhe qëllimit të shërbimeve: kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që drejtpërdrejt do të jenë të përfshirë dhe përgjegjës për sigurimin e shërbimeve; listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin. Kur shërbimet janë siguruar për ndonjë autoritet publik në Kosovë ose në vendin tjetër si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë publik si dhe referenca; kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë si dhe referenca.

4.1.2.2 Raportin mbi fuqinë mesatare punëtore dhe numrin mesatar të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik për secilin nga tri vitet e fundit.

4.1.2.3 Raportin mbi mjetet, stabilimentet ose pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik për realizimin e shërbimeve.

4.1.2.4 Përshkrimin e masave që do të merren nga operatori ekonomik për të siguruar cilësinë dhe pajisjet për hulumtime e zhvillim.

4.1.3 Ne rastin e punëve mund të kërkohen dëshmi me të cilat dëshmohet aftësia teknike dhe profesionale e operatorëve ekonomikë për kryerjen e projekteve të tilla ose realizimin e punëve të tilla, si: kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që drejtpërdrejt do të jenë përgjegjës për realizimin e projekteve të punës ose për realizimin e aktiviteteve ndërtimore; listën me të cilën specifikohen të gjitha projektet e punëve dhe aktivitetet ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me certifikata për kryerje dhe/ose përfundim të kënaqshëm të projekteve (përfshirë referencat) më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore; certifikatat që përcaktojnë vlerën, datën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore dhe specifikojnë nëse janë kryer dhe/ose përmbushur dhe janë përfunduar siç duhet; raportin për mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik për realizimin e projektit të punëve ose përmbushjen e aktiviteteve ndërtimore; raportin për fuqinë mesatare punëtore dhe numrin mesatar të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik për secilin nga tri vitet e kaluara; dhe raportin për teknikët ose njësitë teknike në të cilët mund të thirret kontraktuesi për zbatimin e projektit të punëve ose realizimin e aktiviteteve ndërtimore.

4.2. Sa i përket kapacitetit ekonomik e financiar të operatorëve ekonomikë, Banka Qendrore mund të kërkojë dëshmi se ata i përmbushin kushtet minimale ekonomike dhe financiare të specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës.

4.2.1. Ne rastet kur kërkohet qarkullim minimal vjetor që operatorët ekonomikë duhet ta përmbushin, kërkesa nuk do të kalojë dy (2) herë vlerën e parashikuar të kontratës. Kjo kërkesë duhet të shprehet detyrimisht në shifra në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, dhe do t'i referohet maksimum tri viteve të fundit financiare. Kur përveç qarkullimit minimal është i nevojshëm një qarkullim i caktuar minimal në fushën specifike të mbuluar nga kontrata, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë një pikë pesë (1.5) herë vlerën e parashikuar të kontratës.

4.2.2. Në përgjithësi, operatorëve ekonomikë u lejohet të plotësojnë kërkesën sipas paragrafit 4.2.1 më lart duke paraqitur, nëse është me rëndësi dhe e nevojshme, një ose më shumë nga referencat e dhëna në vijim: raportin ose raportet përkatëse nga një ose më shumë banka; evidencë të një police të sigurimit të lëshuar nga një kompani e licencuar e sigurimeve; kopjet e certifikuar të një ose më shumë bilanceve të gjendjes ose ekstrakteve nga bilanci e gjendjes nëse kërkohet publikimi i bilanceve të tilla të gjendjes në kuadër të ligjit në vendin e themelimit të operatorit ekonomik; kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuar nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur; deklaratat tatimore vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.

5. Nëse për ndonjë arsye të veçantë të cilën Banka Qendrore e konsideron të arsyeshme, kandidati apo tenderuesi nuk është në gjendje të ofrojë dokumentet e kërkuara, ai mund ta dëshmojë kapacitetin e vet me anë të mjeteve të tjera të cilat Banka Qendrore i konsideron të përshtatshme.

6. Një ofertues mund, sipas nevojës edhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e entiteteve të tjera, pavarësisht natyrës ligjore të lidhjeve të cilat i ka me to. Në atë rast ai duhet t'ia dëshmojë Banka Qendrore se i ka në dispozicion resurset e nevojshme për përmbushjen e kontratës. Sipas kushteve të njëjta, një grupim i përkohshëm i furnizuesve mund të mbështetet në kapacitetet e pjesëmarrësve në grup.

Neni 33 **Grupet ofertuese të partneritetit konzorciumet**

1. Grupet e operatorëve ekonomikë si konzorciume mund të marrin pjesë në procedurat e prokurimit sipas kësaj Rregulle prej të cilëve nuk kërkohet që të marrin përsipër ndonjë formë të veçantë ligjore për të paraqitur tenderin. Nga grupet e përzgjedhura mund të kërkohet një gjë e tillë pasi që t'iu jepet kontrata, për aq sa kjo është e nevojshme, për përmbushjen e mjaftueshme të kontratës.

2. Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomikë, tenderi duhet të përmbajë një deklaratë të nënshkruar nga secili prej anëtarëve të grupit, që konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtën procedure tenderimi. Në rast se një anëtar i një grupi tenderues merr pjesë në dy apo më tepër grupe për të njëjtin tender, secili nga grupet përkatëse ku është i përfshirë ky anëtar do të konsiderohet i papërgjegjshëm dhe përjashtohen si të tilla.

3. Të gjithë anëtarët e grupit ose konzorciumit do të jenë së bashku dhe secili veçmas përgjegjës para Bankës Qendrore për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe nëse kontrata përkatëse i jepet grupit në fjalë, ata gjithashtu do të jenë së bashku dhe veçmas përgjegjës për ekzekutimin e kontratës në fjalë.

4. Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit sipas nenit 31 të kësaj Rregulle. Kurse kërkesat për kriteret e përzgjedhjes që kanë të bëjnë me kapacitetin ekonomik, financiar, teknik e profesional, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individualë të konzorciumit.

Neni 34

Kriteret për dhënie

1. Banka Qendrore specifikon në njoftimin për kontratë dhe/apo në ftesën për tender nëse kontratën do t'ia japë tenderuesit që paraqet tenderin ekonomikisht më të favorshëm apo tenderuesit të përgjegjshëm që ofron çmimin më të ulët.

2. Nëse kontrata i jepet tenderuesit me ofertën ekonomikisht më të favorshme, atëherë Banka Qendrore në njoftimin për kontratë apo në ftesën për tender, ose në rastin e procedurës së negociuar në kërkesën për pjesëmarrje i specifikon:

2.1. Kriteret kualitative sipas të cilave vlerësohen tenderët, të cilat duhet të ndërlidhen me çështjen lëndore të kontratës në fjalë dhe mund të përfshijnë si vijon:

2.1.1. Kriteret që lidhen me koston: çmimi, kostot rrjedhëse, kostot e funksionimit, shërbimet pas shitjes, trajnimet, pjesët e këmbimit, etj.

2.1.2. Kriteret që nuk lidhen me koston: kualiteti, meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, karakteristikat ambientuese, datën e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit apo periudhën e përfundimit.

2.2. Peshimin relativ që iu bëhet secilit prej kriterëve të zgjedhura për përcaktimin e tenderit më të favorshëm ekonomikisht. Këto peshime mund të shprehen duke marrë parasysh shkallën e shtrirjes së duhur maksimale. Nëse, sipas vlerësimit të Bankës Qendrore, peshimi nuk është i mundur për arsye demonstrimi, ajo paraqet kriteret sipas rendit të zvogëlimit të rëndësisë.

3. Kriteri i tenderit ekonomikisht më të favorshëm duhet të sigurojë që blerja më e mirë (vlera ekonomikisht më e favorshme) të sigurohet duke marrë parasysh kombinimin optimal të kostos e cila do të përfshijë kostot totale të ciklit të jetës së mallrave, punëve ose shërbimeve. Është e nevojshme të shikohen të gjitha kostot që do të kontribuojnë në kostot e mirëmbajtjes dhe kostot operative që do të jenë të arsyeshme, gjatë jetëgjatësisë së projektit.

Neni 35

Vlerësimi - Çështje të përgjithshme

1. Banka Qendrore vlerëson të gjithë tenderët sipas kriterëve për dhënie të referuara në nenin 28 të kësaj Rregulle pasi të ketë:

1.1. Verifikuar kërkesat formale për tender;

1.2. Verifikuar përshtatshmërinë e tenderuesve siç referohet në nenin 31 të kësaj Rregulle;

1.3. Vlerësuar përmbushjen e kriterëve të përzgjedhjes të referuara në nenin 32 të kësaj Rregulle.

2. Banka Qendrore i jep kontratën tenderuesit që më së miri i plotëson kriteret për dhënie.
3. Kërkesat dhe tenderët nuk hapen para datës dhe kohës së fundit të caktuar për dorëzimin e tyre. Hapja e ofertave si proces realizohet në përputhje me nenin 36 të kësaj Rregulle. Përveç nëse specifikohet ndryshe, kandidatët apo tenderuesit mund të mos marrin pjesë në hapje.
4. Në procedurat ku kriter i vlerësimit është oferta e përshtatshme me çmimin më të ulët, në rastet kur paraqiten dy apo më shumë oferta me çmimin e njëjtë, fitues shpallet operatori ekonomik / tenderuesi që ka dorëzuar ofertën i pari në Bankën Qendrore.
5. Procesi i vlerësimit dhe rezultati dokumentohen në një raport të vlerësimit.
6. Për procedurat e prokurimit me vlera mbi pragjet nga neni 19, do të aplikohet metoda e prokurimit e ndarjes së ofertës teknike nga ajo financiare, sipas rastit.

Neni 36 **Komisioni Vlerësues**

1. Komisioni vlerësues emërohet *ad hoc* nga Guvernatori apo i/e autorizuar/a i tij/saj, në përbërje prej së paku tre (3) anëtarëve (nga njësi të ndryshme organizative), me propozimin e Divizionit të Prokurimit dhe Kontraktimit. Komisioni vlerësues asistohet nga një zyrtar i Divizionit të Prokurimit dhe Kontraktimit.
2. Funksionet e Komisionit vlerësues janë:
 - 2.1. Hapja e ofertave dhe e kërkesave për pjesëmarrje në afatin e caktuar në njoftimin për kontratë respektivisht në dosjen e tenderit.
 - 2.2. Vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit/kandidatët. Ofertat vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata i jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë.
3. Parimet në vijim duhet të krijojnë bazën për caktimin dhe për funksionimin e komisionit vlerësues:
 - 3.1. Anëtarët e komisionit duhet të përmbushin kërkesat në lidhje me përshtatshmërinë, duhet të nënshkruajnë një deklaratë me shkrim (Deklarata nën betim).
 - 3.2. Të gjithë anëtarët e komisionit ruajnë informatat sekrete afariste.
 - 3.3. Banka Qendrore cakton nga radhët e anëtarëve të komisionit, një kryesues të komisionit që e drejton punën e tij dhe siguron që është në pajtim me këtë Rregull.
 - 3.4. Vendimi mbi caktimin e komisionit paraqet qartë detyrat që duhet të ekzekutohen nga

komisioni, i cili në asnjë rast nuk e kufizon pavarësinë e procesit të vendimmarrjes.

3.5. Procedura për vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve kryhet nga Komisioni i vlerësimit brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 20 (njëzet) ditë pune nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në veçanti me kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej dhjetë (10) ditësh.

3.6. Komisioni funksionon nga dita e miratimit të vendimit lidhur me themelimin e tij deri në plotësimin e të gjitha detyrave të dhëna nga Banka Qendrore me shkrim, ose derisa të mund të merret vendimi për ndërprerjen e procedurës së prokurimit. Në rast se një apo më shumë anëtarë të komisionit nuk janë në gjendje të marrin pjesë si anëtarë të komisionit, për shkaqe e rrethana objektive, ata zëvendësohen në të njëjtën mënyrë sikur edhe janë caktuar.

3.7. Komisioni i merr vendimet e tij rreth vlerësimit në takime me votë të thjeshtë të shumicës me votim të hapur.

3.8. Banka Qendrore ka të drejtë të ftojë, vetë ose me iniciativën e komisionit, ekspertë të jashtëm për vlerësim atëherë kur kërkohen njohuri teknike ose të specializuara për lëndën e prokurimit në mungesë të një profili të tillë brenda Bankës Qendrore. Ekspertët e tillë duhet të pranojnë me shkrim mbrojtjen e informatave sekrete afariste.

3.9. Në përfundim të detyrës së tij, komisioni i jep prokurimit një rekomandim shoqëruar me një raport dhe një deklaratë me arsyet që e mbështesin atë rekomandim. Rekomandimi nuk përben obligim për BQK-në, përkatësisht për Divizionin e Prokurimit dhe Kontraktimit, dhe as nuk publikohet, prandaj nuk përben pretendim – të drejtë për aplikuesin.

3.10. Mbi bazën e vlerësimit nga raporti i komisionit vlerësues, Divizioni i Prokurimit dhe Kontraktimit mund të shpallë vendimin për dhënien e kontratës apo anulim. Divizioni i Prokurimit dhe Kontraktimit mund ta pranojë ose ta refuzojë rekomandimin e komisionit. Në rast se refuzohet rekomandimi i komisionit, jepen arsyet me shkrim dhe përmes Zëvendësguvernatorit për Funksione të Përgjithshme informohet Guvernatori për vendimin final. Ky raport mbetet pjesë e regjistrit të aktiviteteve të prokurimit.

3.11 Divizioni i Prokurimit dhe Kontraktimit në pajtim me paragrafin 3.10 të këtij neni e pranon ose refuzon rekomandimin e komisionit brenda 5 ditë pune nga marrja e rekomandimit, përveç rasteve kur kërkohet sqarim shtesë në nivelet e vendimmarrjes.

Neni 37

Tenderët jonormalisht të ulët ose jonormalisht të lartë

1. Banka Qendrore mund të refuzojë një procedurë tenderuese në rastet kur konstaton se oferta është jonormalisht e ulët apo jonormalisht e lartë në lidhje me mallrat, punët apo shërbimet e ofruara, të cilat argumentohen në masën e mjaftueshme. Rastet e tilla analizohen në fazën e vlerësimit të ofertave nga komisioni vlerësues në bashkëpunim me Divizionin e Prokurimit dhe Kontraktimit, duke u bazuar në krahasimin ofertave mes tyre si dhe me buxhetin e ndarë për prokurimin përkatës.

2. Para refuzimit të tenderëve të tillë, Banka Qendrore mund t'i kërkojë me shkrim hollësitë e elementeve përbërëse të tenderit të cilat i konsideron relevante. Hollësitë kryesisht kanë të bëjnë me çështjet e përcaktuara në vijim:

2.1. Ekonominë e procesit të prodhimit, të ofrimit të shërbimeve apo të metodës së ndërtimit;

2.2. Zgjidhjet teknike të përzgjedhura apo çdo kusht jashtëzakonisht të favorshëm që është në dispozicion të tenderuesit;

2.3. Origjinalitetin e tenderuesit;

2.4. Zbatimin e procedurave që kanë të bëjnë me mbrojtjen e marrëdhënieve të punës dhe kushteve të punës në fuqi në vendin ku kryhet puna, shërbimi apo furnizimi. Banka Qendrore mund t'i verifikojë ato pjesë përbërëse të elementeve duke marrë parasysh sqarimet dhe dëshmitë e pranuar.

3. Banka Qendrore, gjatë procesit të ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave, do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike në ofertë (sipas elementeve të listuara). Ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se 2% (dy për qind) e vlerës totale të ofertës përkatëse, dhe për çdo përmirësim do të njoftohen të gjithë tenderuesit.

4. Në rast të përmirësimit aritmetik sipas paragrafit 3 të këtij neni, Banka Qendrore do ta njoftojë tenderuesin oferta e të cilit është përmirësuar aritmetikisht dhe nga i cili kërkon që ta pranojë përmirësimin. Nëse tenderuesi nuk pajtohet me përmirësimin atëherë oferta e tij do të refuzohet respektivisht eliminohet nga procedura.

5. Në të gjitha rastet tjera kur pas përmirësimeve nga Banka Qendrore konstatohet se gabimet aritmetike janë më të mëdha se 2% e vlerës së ofertës, Banka Qendrore do t'i eliminojë ofertat e tilla.

6. Gabimet aritmetike në llogaritjen e çmimit do të korrigjohen në këtë mënyrë:

6.1. Në rast se ka mospërputhje në ofertë ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total (i cili është fituar duke shumëzuar çmimin për njësi me sasinë përkatëse), atëherë mbizotëron çmimi për njësi dhe do të korrigjohet çmimi total.

6.2. Në rast se ka mospërputhje ndërmjet çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve, oferta refuzohet.

6.3. Në asnjë rast çmimi për njësi nuk mund të korrigohet. Në rast se tenderuesi pretendon se ka bërë një gabim në çmimin për njësi, tenderi i tij do të refuzohet dhe konsiderohet si i tërhequr.

7. Në rastet kur tenderuesi ofron çmimin zero (0.00) euro për një artikull/pozicion të caktuar, atëherë Banka Qendrore përmes kërkesës për sqarime shtesë nga tenderuesi i tillë kërkon shpjegim dhe:

7.1. Nëse tenderuesi pranon se ai artikull/pozicion i veçantë nuk është i përfshirë në tender, atëherë tenderi i tij refuzohet.

7.2. Nëse tenderuesi deklaron se artikulli/pozicioni i caktuar është ofruar falas, atëherë tenderi i tij refuzohet pasi që dhuratat nuk janë të pranueshme. Ky paragraf nuk zbatohet në rastet e shërbimeve të mirëmbajtjes të cilat ofrohen në kuadër të kontratës përkatëse.

Neni 38 **Ri-vlerësimi**

Në rast se deri në fazën para shpalljes së fituesit, Guvernatori apo i autorizuari i tij/saj dhe/ose Divizioni i Prokurimit dhe Kontraktimit konstaton parregullsi, të meta, mangësi ose shkelje gjatë një procedure të prokurimit, atëherë ajo procedurë pezullohet dhe shpie në dy mundësi: kthimin e procedurës në rivlerësim ose anulimin e procedurës.

Neni 39 **Njoftimi i vendimeve për dhënie të kontratës ose refuzim**

1. Sa më parë që të jetë e përshtatshme për të, Banka Qendrore i njofton me shkrim për vendimin e saj të gjithë kandidatët apo tenderuesit lidhur me dhënien e kontratës apo/edhe për refuzimin.

2. Njoftimi për dhënien e kontratës bëhet së paku pesë (5) ditë para nënshkrimit të kontratës nga Banka Qendrore, kjo kërkesë nuk zbatohet për kontratat me vlerë të vogël dhe minimale.

3. Kandidatët dhe tenderuesit mundën që brenda pesë (5) ditësh nga pranimi i njoftimit për dhënie të kontratës apo për refuzim të tenderit të kërkojnë nga Banka Qendrore t'u japë arsyet për refuzimin e kërkesës apo tenderit të tyre.

4. Banka Qendrore mund të mos japë informata të caktuara nëse lëshimi i informatave të tilla ndikon në interesat legjitime afariste të ofertuesve të tjerë, pengon zbatimin e ligjit apo është në kundërshtim me interesat publike.

5. Çdo ofertues i cili dëshiron të dijë arsyet për të cilat oferta e tij nuk është zgjedhur, mund të kërkojë një shpjegim nga Divizioni i Prokurimit dhe Kontraktimit. Divizioni i Prokurimit dhe Kontraktimit siguron brenda tre (3) ditësh me shkrim një shpjegim, pse oferta e tillë nuk është përzgjedhur.

6. Veç kësaj Banka Qendrore e publikon njoftimin për dhënie në ueb-faqen zyrtare të saj lidhur me rezultatin e procedurës së prokurimit.

Neni 40

Sigurimi i ekzekutimit të kontratës

1. Banka Qendrore mund të kërkojë nga tenderuesit të cilit i është dhënë kontrata që të depozitojë një siguri të ekzekutimit si parakusht për nënshkrimin dhe hyrjen në fuqi të kontratës së tillë. Duke iu referuar nenit 19, për kontratat me vlerë të vogël, kërkohet sigurim i kontratës sipas rastit dhe sipas natyrës së projektit, ndërsa për kontratat me vlerë të mesme dhe ato me vlerë të madhe, sigurimi aplikohet në çdo rast.

2. Banka Qendrore siguron që shuma e çfarëdo sigurie të ekzekutimit që kërkohet nga paragrafi 1 i këtij neni të jetë e barabartë me së paku dhjetë për qind (10%) të vlerës së kontratës.

3. Sigurimi i ekzekutimit mund të bëhet në letër krediti, sigurim të performancës, ose siguri bankare, të lëshuara nga një institucion financiar i licencuar (bankë ose kompani sigurimi) që merr përsipër në formë të pakushtëzuar t'i bëjë pagesën Bankës Qendrore menjëherë me kërkesë, pa vërtetime të mëtutjeshme apo kushte, dhe pa zbritje nga shuma e specifikuar, dhe ekzekutohet nga Banka Qendrore në rast se operatori ekonomik është në shkelje të obligimeve.

4. Nëse nuk ka ngjarë asgjë që mund të shkaktojë konfiskimin e sigurisë së ekzekutimit të kontratës, Banka Qendrore me kërkesë të tenderuesit ia kthen fondet ose dokumentet që janë depozituar në formë të sigurisë së ekzekutimit, në përputhshmëri me kushtet e tenderit përkatës.

5. Përveç kushtit të sigurimit të ekzekutimit të kontratës sipas paragrafit 1 të këtij neni, Banka Qendrore mund të aplikojë edhe kushte tjera të sigurimit të kontratës varësisht nga objekti i kontratës.

Neni 41

Kontraktimi

1. Të gjitha kontratat e prokurimit, përfshirë ato për furnizime, punë dhe shërbime, hartohen me kushte të përgjithshme, pas shpalljes së fituesit të tenderit. Në raste të veçanta, kontratat që përmbajnë kushte specifike dërgohen për shqyrtim në Departamentin Ligjor.

2. Kontraktimi si funksion në kuadër të Divizionit të Prokurimit dhe Kontraktimit merr përsipër hartimin e një kontrate sipas kushteve të një tenderi dhe në harmoni me këtë rregull. Kontratat

e prokurimit do të përdoren në formatin standard të kontratave për furnizime, kontratave për punë dhe atyre për shërbime.

3. Draft kontrata e përgatitur i dërgohet fituesit përkatës të tenderit për ta njoftuar paraprakisht me kushtet specifike të kontratës dhe kërkohet konfirmimi nga ana e palës.

4. Kontraktimi si funksion do të kujdeset tutje për monitorimin e realizimit të kontratës së prokurimit, sipas kushteve të specifikuara në kontratë. Monitorimi fillon në momentin e nënshkrimit të kontratës e deri në realizimin final të saj. Ndër të tjera, aty përfshihen afatet kohore të kontratës, kushtet e pagesës, sigurimi i ekzekutimit të kontratës, etj.

5. Interpretimi i kushteve të kontratës do të jetë një përgjegjësi tjetër në kuadër të kontraktimit, ku palët e interesuara për sqarime mund t'i adresojnë kërkesat e tyre.

6. Afatet për nënshkrim të kontratës nga palët nënshkruese janë përcaktuar qartë në nenin 46 të kësaj Rregulle.

7. Tenderuesi paraqet në tenderin e tij nëse do të nënkontrakttojë ndonjë pjesë të kontratës palëve të treta dhe prezanton secilin nënkontraktues të propozuar. Nënkontraktimi nuk mund të tejkalojë vlerën monetare prej 40% të vlerës totale të kontratës.

8. Secili nënkontraktor i propozuar duhet të përmbushë kërkesat e përshtatshmërisë dhe duhet të dorëzojë dëshmitë mbi përmbushjen e kërkesave të përshtatshmërisë sipas nenit 30 të kësaj Rregulle. Në të kundërtën, Banka Qendrore do ta eliminojë tenderuesin për të cilin nënkontraktuesi nuk i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë.

9. I njëjti nënkontraktues mund të propozohet nga më shumë se një tenderues. Në rast se tenderuesi nuk ka deklaruar nënkontraktim të ndonjë pjese në tenderin e tij, gjatë ekzekutimit të kontratës nuk i lejohet të nënkontrakttojë ndonjë pjese të kontratës.

Neni 42

Menaxhimi i kontratës

1. Çdo kontratë e prokurimit duhet të përmbajë dispozitën për caktimin e menaxherit të kontratës dhe e njëjta nënshkruhet edhe nga menaxheri i kontratës.

2. Menaxher i kontratës caktohet një zyrtar nga njësia kërkuese dhe varësisht nga kompleksiteti i kontratës mund të caktohen më shumë se një menaxher.

3. Menaxheri i kontratës propozohet nga udhëheqësi i njësisë organizative kërkuese me kërkesë të Divizionit të Prokurimit dhe Kontraktimit dhe caktohet nga Zëvendësguvernatori për Funksione të Përgjithshme.

4. Varësisht nga lloji dhe kompleksiteti i kontratës, mund të caktohet edhe një mbikëqyrës i kontratës që mund të jetë ekspert i jashtëm ose konsulent (firmë ose individ). Ky proces zhvillohet në pajtim me nenin 4, paragrafi 2, të kësaj Rregulle.

5. Detyrat dhe funksionet e menaxherit të kontratës janë:

5.1. Menaxhon obligimet dhe detyrat e specifikuara në kontratë dhe siguron se kontraktuesi kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës.

5.2 Siguron që kontraktuesi i përmbush të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

5.3 Siguron që kontraktuesi e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

5.4 Kujdeset që Banka Qendrore i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

5.5 Siguron se ka kontroll adekuat të kostove, cilësisë, dhe kohës sipas kushteve të kontratës;

5.6 Siguron që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;

5.7 Siguron që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të mbahen dhe arkivohen siç kërkohet;

5.8 Siguron dhe ofron detaje të plota për Divizionin e Prokurimit dhe Kontraktimit për një ndryshim të kërkuar të kontratës;

5.9 Ofron detaje të plota për Divizionin e Prokurimit dhe Kontraktimit për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës;

5.10 Raporton në baza periodike tek Komiteti i Projekteve mbi ecurinë, sfidat dhe nivelin e zbatimit të projektit; në rast se kontrata nuk zbatohet apo ka dobësi në procesin e zbatimit, menjëherë njofton Komitetin dhe Zëvendësguvernatorin për Funksione të Përgjithshme;

5.11 Menaxhon procedurën e pranimit të furnizimit, punës dhe/ose shërbimit; dhe

5.12 Përgatit dhe dorëzon raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate siç mund të kërkohet nga Divizioni i Prokurimit dhe Kontraktimit ose menaxhmenti.

6. Gjatë menaxhimit të kontratave të prokurimit duhet të trajtohen tri fusha kryesore të rrezikut:

6.1. kostoja, rastet e tejkalimit të shumës kontraktuese dhe ndonjë humbje tjetër financiare;

6.2. koha, vonesat e mundshme në realizimin e furnizimeve, punës apo shërbimeve që rezultojnë jashtë afateve kohore të kontraktuara; dhe

6.3. cilësia, rastet e humbjes së cilësisë për furnizimet, punët apo shërbimet e kontraktuara.

7. Menaxhimi i kontratave të prokurimit nga menaxherët përkatës bëhet sipas Planit për menaxhim të kontratave. Formulari standard i planit të menaxhimit të kontratave u përcillet menaxherëve me kohë dhe këta të fundit e përcjellin implementimin e kontratës sipas planit

përkatës. Plani përfshin çështjet e aspekteve organizative, ekonomike, teknike dhe ligjore të menaxhimit të kontratave duke përfshirë në bazë të rrethanave: ekipet e menaxhimit të projekteve; rishikimet e kontratës; protokollet për dorëzimin e pajisjeve të autorizuara; dialogun e rregullt me kontraktuesit; përdorimin e standardeve korrekte të cilësisë; menaxhimin e pagesave; procedurat e ankesave; mjetet e kontrollit të specifikuar në kontratë, dhe sigurimin e ekzekutimit që mbahet për defekte / korrigjim.

Neni 43

Kohëzgjatja e kontratës dhe vazhdimet

1. Afati i kontratës, duke përfshirë vazhdimet, nuk e tejkalon periudhën pesë (5) vjeçare, me përjashtim të rasteve ku lënda e kontratës apo ndonjë arsye legjitime e justifikon kohëzgjatjen e afatit. Në raste të veçanta kur argumentohet diçka e tillë, me propozim të Zëvendësgubernatorit për Funkcionet e Përgjithshme dhe konfirmim të Guvernatorit, shqyrtimi dhe aprovimi i afatit më të gjatë bëhet në Bordin Ekzekutiv.

2. Nëse një kontratë lidhet për një afat të caktuar, afati i saj mund të vazhdohet më gjatë se afati fillestar sipas kushteve në vijim:

2.1. Në njoftimin për kontratë, apo në rast të procedurës sipas nenit 11 të kësaj Rregulle në kërkesën për propozim, është paraparë mundësia e vazhimit;

2.2. Vazhdimet e mundshme arsyetohen mirë;

2.3. Vazhdimet e mundshme janë marrë parasysh kur është bërë llogaritja e vlerës së kontratës në përputhje me nenin 18 të kësaj Rregulle.

3. Totali i përgjithshëm i vazhdimeve nuk duhet të tejkalojë afatin e kontratës fillestare.

4. Në rastet e kontratave me afat më të gjatë se afati i parapare sipas paragrafit 1 të këtij neni, njësia kërkuese përmes njësisë së financave të Bankës Qendrore duhet të sigurojë bazë të arsyeshme se aprovimi i buxhetit do të bëhet për secilin vit për tërë periudhën e afatit të kontratës përkatëse.

5. Përjashtimisht nga paragrafët më lart të këtij neni, kohëzgjatja e kontratës me një auditor të jashtëm nuk tejkalon një periudhë të vazhdueshme më të gjatë se pesë (5) vjet, pas së cilës periudhë auditorët e jashtëm duhet të ndërrohen.

6. Çmimet e kontratave të prokurimit mund të rregullohen përgjatë periudhës së implementimit në rastet kur ka ndryshime sipas vendimeve të organeve kompetente shtetërore, në tatime, në normën e TVSh-së apo ndryshime në tarifatat për import. Rregullimet e tilla duhet të jenë të lidhura me indekse zyrtare të çmimeve të përcaktuar nga autoritete në Kosovë ose nga institucionet tjera ndërkombëtare të autorizuara.

Neni 44

Furnizimet, shërbimet dhe punët shtesë

1. Banka Qendrore mund të kërkojë furnizime, shërbime apo punë shtesë nga kontraktuesi të cilit i është dhënë kontrata fillestare, me kusht që:

1.1. Në dokumentacionin e tenderit të lëshuar për furnizime, shërbime apo punë shtesë është paraparë si opsion; dhe

1.2. Furnizimet, shërbimet apo punët shtesë janë marrë parasysh gjatë llogaritjes së vlerës së kontratës në përputhje me nenin 18 të kësaj Rregulle.

2. Përveç kësaj, Banka Qendrore mund të kërkojë nga kontraktuesi fillestar furnizime, shërbime apo punë shtesë të cilat bëhen të nevojshme për përmbushjen e qëllimit të kontratës si pasojë e rrethanave të paparashikueshme, me kusht që:

2.1. Furnizimet, shërbimet apo punët shtesë nuk mund të ndahen teknikisht apo ekonomikisht nga kontrata fillestare pa vështirësi të mëdha; apo

2.2. Furnizimet, shërbimet apo punët, ndonëse të ndara nga përmbushja e kontratës fillestare, janë medoemos të nevojshme për përmbushjen e saj. Megjithatë, vlera e përbashkët e furnizimeve, shërbimeve apo punëve shtesë si rregull nuk tejkalon tridhjetë për qind (30%) të shumës së kontratës fillestare.

3. Nëse nuk plotësohen kushtet e përcaktuara sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, kontratat për furnizime, shërbime apo punë shtesë mund të jepen vetëm në përputhje me nenet e Kapitullit II të kësaj Rregulle.

KAPITULLI IV

PROKURIMET NËN NIVELIN E PRAGJEVE

Neni 45

Procedura pa publikimin e njoftimit

1. Kontratat, vlera e përgjithshme e llogaritur e të cilave është nën pragjet e specifikuar në nenin 19, paragrafi 3, të kësaj Rregulle jepen në përputhje me procedurën sipas këtij neni.
2. Nëse vlera e parashikuar e kontratës nuk tejkalon shumën shtatë mijë (7.000) euro për mallra dhe shërbime apo pesëmbëdhjetë mijë (15.000) euro për punë, Banka Qendrore fton së paku pesë (5) ofertues të përshtatshëm, nëse janë në dispozicion për ta paraqitur tenderin. Nëse vlera e përgjithshme e përlllogaritur e kontratës është nën këto pragje por është e barabartë apo mbi pesë mijë (5.000) euro, Banka Qendrore i fton së paku tre (3) furnizues nëse janë në dispozicion, për ta paraqitur tenderin. Në të dyja rastet, procedura zhvillohet sipas nenit 13 të kësaj Rregulle.
3. Banka Qendrore zgjedh ofertuesit të marrin pjesë në procedurën e tenderimit, nga lista e ofertuesve të regjistruar apo kur nuk ka një listë të këtillë të krijuar, në bazë të analizës së duhur të tregut. Zgjedhja e ofertuesve të përshtatshëm varet nga vetë përzgjedhja e Bankës Qendrore. Listat e ofertuesve të regjistruar janë të hapura për çdo furnizues të interesuar që ofron llojet e furnizimeve, shërbimeve dhe punëve për të cilat është krijuar lista. Banka Qendrore shpall rregullisht me anë të mjeteve të duhura mundësinë për t'u regjistruar në këto lista.
4. Në mënyrë alternative, Banka Qendrore mund të publikojë njoftimin për kontratë në faqen e saj të internetit duke shfrytëzuar mediat e duhura. Në këtë rast, ftesa për kuotim iu dërgohet të gjithë ofertuesve që kanë shprehur interesimin e tyre për të marrë pjesë brenda afatit të caktuar.
5. Tenderët e pranuar vlerësohen sipas kriterëve të përcaktuara në ftesën për kuotim. Banka Qendrore ia jep kontratën tenderuesit që më së miri i plotëson kriteret e caktuara në ftesën për kuotim.
6. Për zbatimin e kësaj procedure kërkohet miratim paraprak nga Guvernatori apo i/e autorizuari/a i tij/saj.

KAPITULLI V

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 46

Nënshkrimi i kontratave

1. Të gjitha kontratat e prokurimit në Bankën Qendrore nënshkruhen nga Guvernatori apo i/e autorizuari/a i/e tij/saj.
2. Pas shfrytëzimit të së drejtës së ankesës sipas nenit 48 të kësaj Rregulle, Banka Qendrore e njofton operatorin ekonomik fitues për nënshkrim të kontratës. Nënshkrimi i kontratës duhet të bëhet brenda 5 (pesë) ditë pune nga njoftimi. Me kërkesë të operatorit ekonomik me arsyetim të bazuar, afati mund të zgjatet për 5 ditë tjera pune për nënshkrim të kontratës.
3. Nëse operatori ekonomik fitues refuzon nënshkrimin e kontratës brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni, pas dhënies së një afati shtesë, nëse e sheh të nevojshme, Banka Qendrore e anulon njoftimin për dhënie të kontratës si dhe tërë procedurën e prokurimit.
4. Në rastet e refuzimit të nënshkrimit të kontratës sipas paragrafit 3 të këtij neni nga operatori ekonomik, kur është e aplikueshme zbatohet neni 30 i kësaj Rregulle.

Neni 47

Anulimi i procedurave të prokurimit

1. Banka Qendrore mund të anulojë një procedurë prokurimi në çdo kohë para nënshkrimit të kontratës duke mos iu dhënë të drejtë kandidatëve apo tenderuesve që të kërkojnë ndonjë kompensim.
2. Vendimi i Bankës Qendrore për anulim është në pajtim me parimet e përcaktuara në nenin 4 të kësaj Rregulle.
3. Në të gjitha rastet e anulimit, Banka Qendrore i njofton kandidatët/ofertuesit për këtë anulim pa qenë e detyruar të japë shkaqet e këtij anulimi.

Neni 48

Procedura e ankesës

1. Në procedurat e prokurimit sipas Kapitullit II të kësaj Rregulle, kandidatët/ofertuesit mund të kundërshtojnë me shkrim vendimin e Bankës Qendrore për refuzim të kërkesës apo tenderit të tyre brenda pesë (5) ditësh nga marrja e njoftimit sipas kësaj Rregulle me kusht që ata klasifikohen si palë e interesuar nga ana e Bankës Qendrore. Ankesa përfshin të gjitha informatat mbështetëse dhe kundërshtimet e arsyetuara.

2. Ankesa shqyrtohet nga Komisioni i ankesave. Nëse Komisioni konstaton se ankesa është e bazuar atëherë ndërmerren masat korrigjuese, që sipas rastit përmbajnë: kthimin e procedurës në rivlerësim ose anulimin e procedurës, përndryshe ankesa refuzohet si e pabazuar. Banka Qendrore e njofton ankuesin me shkrim për vendimin e vet brenda njëzet (20) ditësh pas pranimit të ankesës. Vendimi përmban arsyet në të cilat bazohet.
3. Me marrjen e ankesës Banka Qendrore do të pezullojë procedurën e prokurimit dhe pas shqyrtimit njofton me shkrim ankuesin për vendimin e saj.
4. Shqyrtimi i të gjitha ankesave bëhet nga Komisioni i emëruar nga Guvernatori për një mandat 1-vjeçar. Emërimi i komisionit bëhet me vendim të Guvernatorit në përbërje të së paku tre anëtarëve. Anëtarët e Komisionit të ankesave nuk mund të emërohen anëtar të Komisionit të vlerësimit.
5. Komisioni i ankesave mund të kërkojë informacion nga komisionet vlerësuese si dhe nga profesionistë të fushës brenda BQK-së lidhur me rastin për të cilin është parashtruar ankesa.
6. Ankesat dorëzohen nëpërmjet Divizionit të Prokurimit dhe Kontraktimit, që pas trajtimit të ankesës, ia dorëzon Komisionit të ankesave të gjitha shkresat e lëndës duke përfshirë edhe arsyetimin lidhur me bazën e ankesës.
7. Pala ankuese duhet të paguajë një tarifë për parashtrim të ankesës pranë Bankës Qendrore, vlera e së cilës do të jetë deri në 1% të vlerës së ofertës përkatëse, jo më pak se 100 euro dhe jo më shumë se 2,500 euro. Dëshmia e pagesës duhet t'i bashkëngjitet ankesës dhe dorëzohet përmes njësisë së arkivit të Bankës Qendrore. Pagesa për parashtrimin e ankesës bëhet në xhironlogarinë e përgjithshme rrjedhëse të Bankës Qendrore.
8. Ankesa e parashtruar pa dëshminë e pagesës që duhet të sigurohet nga pala ankuese do të refuzohet që në pranim të parë nga Banka Qendrore.
9. Tarifa e paguar për një ankese do t'i kthehet palës ankuese, nëse Banka Qendrore pas shqyrtimit të ankesës vendos dhe e aprovon ankesën si të bazuar.

Neni 49

Lista e brendshme e ofertuesve të përjashtuar

1. Me propozim të Divizionit të Prokurimit dhe Kontraktimit, komisioni i formuar *ad hoc* nga Guvernatori vendos për përjashtimin nga prokurimet e Bankës Qendrore për një periudhë nga një (1) vit deri në tre (3) vite të:
 - 1.1. Ofertuesve dhe kandidatëve që për kualifikimin e tyre sipas kërkesave të nenit 31 respektivisht 32 të kësaj Rregulle kanë paraqitur dokumente ose informacione të rreme;
 - 1.2. Ofertuesve të shpallur fitues të cilët janë tërhequr nga lidhja e kontratës;

1.3. Kontraktuesve me të cilët është shkëputur kontrata e caktuar për mosrespektim të kushteve kontraktuese.

2. Divizioni i Prokurimit dhe Kontraktimit menaxhon dhe administron me listën e ofertuesve të përjashtuar në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulle.

Neni 50

Juridiksioni

Gjykata kompetente ka juridiksion ekskluziv për çdo kontest ndërmjet Bankës Qendrore dhe furnizuesit lidhur me zbatimin e procedurës së prokurimit. Nëse procedura ankimore është në dispozicion sipas nenit 48 të kësaj Rregulle, ankuesi pret vendimin e Bankës Qendrore lidhur me ankesën para se çështjen t'ia paraqesë Gjykatës. Afatet e caktuara fillojnë të llogariten nga pranimi i vendimit mbi ankesën.

Neni 51

Dosja e tenderit dhe dokumentet tjera

Të gjitha format dhe dokumentacioni tjetër shtesë si dosja e tenderit, njoftimet për kontratë, anulim, raportet vlerësuese, etj., hartohen nga Divizioni i Prokurimit dhe Kontraktimit, në përputhje me kërkesat që dalin nga kjo Rregull dhe si të tilla do të zbatohen dhe ruhen nga ky divizion sipas procedurave e prokurimit të udhëhequra nga Banka Qendrore.

Neni 52

Dispozitë kalimtare

Të gjitha aktivitetet e prokurimit të iniciuara para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle procedohen sipas rregullave të prokurimit të cilat ishin në fuqi në kohën e parashtrimit të tyre në Bankën Qendrore.

Neni 53

Hyrja në fuqi

Kjo Rregull hyn në fuqi më datë 1 dhjetor 2024. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulle shfuqizohet Rregulla e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, e miratuar më datë 27 korrik 2021, dhe çdo dispozitë tjetër që mund të bie në kundërshtim me këtë Rregull.

Ahmet Ismaili
Kryesues i Bordit Ekzekutiv